

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5901
E premte, 11 tetor 2019
çmimi 0.40 €

Vetëvendosja dhe
LDK-ja pajtohen për
bashkëqeverisje FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**LEHTËSIA E PADURUESHME
E TË BËRIT PRESION NDAJ
NJË VENDI QË MBIJETON
ME INFUZION!**

F. 13

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



AKTUALE



**KURTI: DIALOGUN
DO TA UDHËHEQ UNË,
JO PRESIDENTI F. 5**

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA
PËR VENDOSJEN E NJË
RADARI NË AEROPORTIN E
GJAKOVËS F. 6**

EKONOMI

**2 MILIARDË E 942 MILIONË
EURO VLERA E KREDIVE NË
KOSOVË F. 8**

**SHEFOET AVDIJA ZGJEDHET
KRYESHEF I POSTËS SË
KOSOVËS F. 9**

SPORT



**KOSOVA FITON MIQËSOREN
NDAJ GJIBALTARIT F. 18**

KRYETARI I NISMËS SOCIALDEMOKRATE, FATMIR LIMAJ, KA REAGUAR PAS
VENDIMIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) PËR RINUMËRIM TË
PJESSHËM TË KUTIVE TË VOTIMIT FAQE 4-5

LIMAJ KËRKON RINUMËRIM TË VOTAVE NË NIVEL VENDI

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, e ka quajtur skandaloz vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për t'i rinumëruar vetëm 313 kuti me fletëvotime. Ai ka

deklaruar se gabimet teknike të cilat i ka pranuar edhe KQZ-ja mund të eliminohen vetëm nëse ndodh rinumërimi i votave në nivel vendi. Sipas tij, pa rinumërim në tërësi të

çdo kutie të votimit KQZ-ja nuk do të jetë në gjendje të shpallë rezultat zgjedhor në përputhje me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës



LAUREATI I NOBELIT PËR LETËRSI, PËRKRAHËS I MILLOSHEVIQIT

Nis peticioni kundër nobelistit Handke



Shkrimtari austriak Peter Handke është fitues i çmimit Nobel për letërsi për vitin 2019. Shpallja e këtij çmimi ka nxitur jo pak reagime pasi Handke që bërë i njohur me qëndrimet kundër fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi forcat serbe në vitin 1999 të cilat u dhanë fund mizorive të forcave serbe në Kosovë. Gjithashtu, Handke kishte mbajtur fjalim në mars të vitit 2006 në funeralin e ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq. Kundër këtij çmimi për austriakun Peter Handke ka iniciuar edhe një peticion online

**Ambasada
e ShBA-së:
Kosova
dhe Serbia
duhet të
shikojnë
kah e
ardhmja**



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Franca kërkon shtyrjen e negociatave me Shqipërinë

PARIS, 10 TETOR - Franca kërkon shtyrjen e një vendimi për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në mbledhjen e javës së ardhshme të Këshillit Evropian. "Zëri i Amerikës" ka mësuar se propozimi që Franca ka hedhur për momentin në tryezën e vendeve anëtare, lidhet së pari me idenë publike të presidentit Emmanuel Macron, për të reformuar fillimisht BE-në përpara se të avancohet me zgjerimin. Në

funksion të kësaj ideje Franca kërkon një qasje të rishikuar të procesit të zgjerimit. Sipas saj negociatat me vendet që duhet të anëtarësohen duhen të jenë graduale, më konkrete dhe procesi të mos jetë automatik dhe i pakthyeshëm, ose e thënë me fjalë të tjera, që në momentin kur nuk vlerësohet përparimi i duhur, procesi të mund të pezullohet.

Kjo, siç shpjeguan burime diplomatike, është në funksion të zbatimit të prekshëm të reformave,

veçanërisht ato që lidhen me shtetin ligjor, luftën kundër krim-it të organizuar dhe korrupsionit si dhe të drejtave themelore.

Sipas propozimit të Francës, brenda pranverës së vitit të ardhshëm, Komisioni Evropian duhet të hartojë këtë qasje apo strategji të re për procesin e zgjerimit. Ndërsa paralelisht, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut i kërkohet që në ndërkohë, të vijojnë me zbatimin e reformave, specifikimi i të cilave mbetet për t'u përcaktuar, por që



mund të jenë, në rastin e Shqipërisë, përafërsisht çka përmban propozimi gjerman

dhe ndonjë element shtesë për të cilën Franca ka një ndjeshmëri të veçantë.

'Shengeni ballkanik', brenda vitit 2021 lëvizje e lirë e qytetarëve

Në deklaratën e përbashkët të kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiq dhe kryeministrit të Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev thuhet se brenda vitit 2021 të eliminohen kontrollet kufitare dhe pengesat e tjera të lëvizjes së lirë brenda rajonit



PRISHTINË, 10 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev u pajtuan të enjten, gjatë një takimi në Novi Sad, që brenda vitit 2021 "të eliminohen kontrollet kufitare dhe pengesat e tjera të lëvizjes së lirë brenda rajonit".

Në deklaratën e përbashkët thuhet se "njerëzit do të jenë në gjendje që të udhëtojnë në rajon me një kartë identiteti të vlefshme. Do të jenë në gjendje që të punojnë kudo në rajon, sapo të kualifikohen për një vend pune. Diplomati do të njihen në gjithë rajonin. Ne do të shtojmë bashkëpunimin kundër krim-it të organizuar ndërkombëtar dhe zotohemi të ndihmojmë njëri-tjetrin duke iu përgjigjur urgjencave të tilla si katastrofat natyrore".

Të tre udhëheqësit ballkanikë i ndalën në përfitimet që ekonomitë e vendeve të rajonit pritet të kenë nga një nismë e tillë. "Ideja është që duhet t'i për-

shpejtojmë dhe nxisim përpjekjet për ekonominë për ta bërë rajonin një destinacion më tërheqës, si për njerëzit tanë që të punojnë dhe jetojnë këtu, ashtu dhe për investimet e huaja direkte", theksoi kryeministri maqedonas Zoran Zaev, gjatë konferencës së përbashkët me gazetarë. Deklarata bën një ftesë të hapur që nismës t'i bashkohen dhe vendet e tjera të rajonit. "Presim me padurim që të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor të mblidhen e të bashkëpunojmë pavarësisht dallimeve që kemi", deklaroi presidenti serb, Vuçiq duke iu referuar qartazi marrëdhënieve të vendit të tij me Kosovën. "Kjo nismë është e rëndësishme për të gjithë rajonin. Nëse duam vërtetë ta krijojmë një gjë të tillë deri në 2021, njerëzit duhet të përpiqen të lënë mënjanë dallimet", tha ai.

Kryeministri Edi Rama shpjegoi se "në thelb qëllimi që na ka bashkuar në këtë format është të shtyjme përpara me më shumë energji e koordinim, procese që

në letër janë shkruar e miratuar më shumë se një herë e të mos presim që këtë ta bëjnë të tjerët për ne".

Rama tha se "kemi rëndë dakord që të mbështesim parimet e një deklaratë të përbashkët titulli i së cilës i thotë të gjitha: Implementimi i 4 lirive themelore të Bashkimit Evropian në rajonin e Ballkanit Perëndimor".

"Ky takim nuk ka ardhur nga hiçi, por dëshiroj ta bëj shumë të qartë, që nuk synon asnjë ekskluzivitet. Përkundrazi, është një hap me synimin për një pro-

ces gjithëpërfshirës. Në deklaratë do të mund të lexoni lehtësisht se flitet gjatë gjithë kohës për "Eastern Balkan Six", por nga ana tjetër ka një rrugë që na sjell deri këtu, një proces që na ka angazhuar të gjithëve me mbështetjen e partnerëve tanë evropianë nga ku kemi mundur të mësojmë s e duhet të bëjmë më shumë pa prituri më shumë nga të tjerët", tha Rama.

Ai shtoi se "duhet të bëjmë më shumë në funksion të njerëzve tanë, të lëvizjes së lirë në këtë territor, të lëvizjes së mallrave dhe të shërbimeve për kapitale në këtë

territor, ku mjafton vetëm një shembull për të kuptuar se sa e nevojshme është të shtyjme sot përpara".

"Theksoj se pavarësisht se e dimë botërisht që ka çështje të hapura në zemër të këtij rajoni, kjo nuk duhet të na pengojë që duke rënë dakord të mos biem dakord për këto çështje, të dakordësohemi për ato që na bashkojnë në funksion të qytetarëve të gjithë këtij rajoni", tha Rama.

Një takim i dytë, është parashikuar të zhvillohet më 10 nëntor në Ohër, të Maqedonisë së Veriut.

Holanda bllokoi negociatat me Shqipërinë



TIRANË, 10 TETOR - Të enjten në Parlamentin holandez, tre deputetë depozituan 3 mocione bllokuese për çeljen e negociatave BE- Shqipëri. Mocionet i kërkojnë qeverisë të votojë kundër në mbledhjen e 17-18 tetorit madje edhe kundër çeljes me kushte siç propozon Gjermania. Në mbledhjen e

ministrave të jashtëm të BE-së në Strasburg, Holanda nuk do të përfaqësohet në nivel ministri pasi shefi i diplomacisë holandeze do të jetë në vizitë në Indi bashkë me kryeministrin. Holanda do të përfaqësohet në këtë takim nga ambasadori i saj në BE, i cili nuk ka asnjë mandat për të negociuar nëse vendet e

tjera të BE-së do të kërkojnë një zbutje të qëndrimit.

Megjithatë ka ende shpresë që Qeveria e Holandës në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të BE-së të mbajë një qëndrim më të moderuar nga ai i parlamentit. Holanda nuk do të vendosë veto nëse Gjermania dhe Franca do të thonë po.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, është takuar me liderin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa

Vetëvendosje dhe LDK-ja pajtohen për bashkëqeverisje

Lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti dhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, janë pajtuar për të qeverisur së bashku në mandatin e ardhshëm. Kjo është bërë me dije të enjten pas takimit Kurti - Mustafa. Ata kanë thënë se në ditët në vijim do të punojnë për përafrimin e objektivave qeverisëse ndërkaq, pasi të përfundojë procesi i numërimit të të gjitha votave, do të përpiqen të gjejnë zgjidhje për mënyrën e participimit në qeveri

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 TETOR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), pas një takimi të liderëve të tyre të mbajtur të enjten, janë pajtuar për fillimin e bisedimeve për krijimin e koalicionit qeverisëse pas zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit. Pas takimit lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka treguar se janë pajtuar që të qeverisin bashkë me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Ai ka treguar se janë marrë vesh që në qeverinë e re do të ketë minimumi 30 për qind përfaqësim të grave. "Kosova ka humbur shumë kohë dhe pritjet e qytetarëve janë

shumë të larta. Pa humbur kohë ne kemi filluar bisedimet duke nisur me idenë e përbashkët për një qeveri sa më efikase dhe një shtet sa më të fuqishëm. Synimi ynë është që t'u dalim zot nevojave të qytetarëve dhe ta orientojmë shtetin kah drejtësia dhe zhvillimi. Jemi pajtuar që të ketë një dysheme prej 30 përqindësh të përfaqësimit gjinor, do të jenë 30 për qind gra në mesin e ministrave dhe zëvendësministrave dhe, po ashtu, do të kemi më pak ministri dhe zëvendësministra", ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se rezultati tashmë është i qartë dhe LV-ja dhe LDK-ja do ta bëjnë qeverinë. "Ekipe tona të LV-së dhe të LDK-së do të takohen për t'i harmonizuar pro-

gramet tona. Ne e uruam njëritjetrin për gjithçka dhe besoj se do të na shkojnë punët mbarë e mirë pasi u pajtuam të qeverisim bashkë. LDK-ja dhe LV-ja do të qeverisin së bashku", është shprehur Kurti.

Kurse sa i përket koalicionit me Listën Serbe, Kurti ka thënë se do ta respektojë Kushtetutën që një ministri të drejtohet nga komuniteti serb. "Nuk do të vrapojmë te Lista Serbe, pa takuar serbët që kanë garuar jashtë Listës Serbe. Nuk do të shkojmë te hapi i dytë pa e bërë të parin me serbët që po e pranojnë shtetin tonë, por po shtypën nga Beogradi. Pazaret politike i keni parë me PAN-in, transparencë radikale do të bëjë qeveria e re. Qeveria e re do të

zgjatë më shumë sesa koha që i ka mbetur presidentit aktual", ka theksuar Kurti.

Pas takimit me Kurtin ka folur edhe lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, duke thënë se në ditët në vijim do të punojnë për përafrimin e objektivave qeverisëse dhe do të përpiqen të gjejnë zgjidhje për mënyrën e participimit në qeveri. Megjithatë, ai ka thënë se vendimin përfundimtar për bashkëqeverisje do ta marrin organet përgjegjëse të LDK-së. "Të nderuar qytetarë, u takuam sot me liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Kurti, dhe diskutuam mundësitë e bashkëqeverisjes LDK - VV, si dy subjekte që dolën fituese në këto zgjedhje. Në ditët në vijim do të punojmë për përafrimin e objektivave qeverisëse, ndërkaq pasi të përfundojë krejtësisht procesi i numërimit të të gjitha votave dhe të dihet subjekti i parë, do të përpiqemi të gjejmë zgjidhje për mënyrën e participimit në qeveri. Vendimin përfundimtar për bashkëqeveris-

je do ta marrin organet përgjegjëse të LDK-së", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa nënkryetarja e LDK-së dhe ish-kandidatja për kryeministre, Vjosa Osmani, ka thënë se të dy partitë treguan vullnetin e mirë për të qeverisur bashkë. "Sapo zhvilluam takimin tonë të parë me LV-në për të diskutuar për mundësitë e bashkëqeverisjes. Kemi diskutuar në nivel të parimeve. Më e rëndësishmja është se të dy partitë treguan vullnetin e mirë për të qeverisur bashkë dhe vullnetin e mirë për të punuar në interes të qytetarëve", ka deklaruar Osmani, duke shtuar se janë në pritje të numërimit të votave me postë dhe votave me kusht para se të arritet një marrëveshje finale.

Në këtë takim ka qenë i pranishëm edhe nënkryetari i Vetëvendosjes, Besnik Bislimi. Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, zgjedhjet e 6 tetorit i ka fituar Lëvizja Vetëvendosje dhe pas saj është renditur LDK-ja.



Ambasada e ShBA-së: Kosova dhe Serbia duhet të shikojnë kah e ardhmja

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë (ShBA) nëpërmjet një deklarate për medie të enjten ka përcjellë porosi pas vizitës së të dërguarit special të presidentit amerikan për negociatat e paqes mes Kosovës dhe Serbisë, ambasadorit Richard Grenell në Prishtinë dhe Beograd.

Sipas Ambasadës së ShBA-së, të dyja palët do të duhet të punojnë ngushtë dhe shpejt duke shikuar nga e ardhmja. "Ambasadori Grenell i filloi të dy ditët duke u takuar së pari me udhëheqësit e komunitetit afarist.

Administrata e presidentit Trump fuqimisht beson se zhvillimi ekonomik, krijimi i vendeve të punës për të rinjtë dhe mitja e

mundësive tregtare luajnë rol kryesor në sigurimin e paqes së qëndrueshme. Qëllimi është për t'i bërë bashkë partnerët tanë në Serbi dhe Kosovë për një zgjidhje gjithëpërfshirëse për pikat e konfliktit në rajon. Të dyja palët do të duhet të punojnë ngushtë dhe shpejt duke shikuar nga e ardhmja", është theksuar në këtë deklaratë të Ambasadës së ShBA-së.





Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka reaguar pas vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për rinumërim të pjesshëm të kutive të votimit

Limaj kërkon rinumërim të votave në nivel vendi

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, e ka quajtur skandaloz vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për t'i rinumëruar vetëm 313 kuti me fletëvotime. Ai ka deklaruar se gabimet teknike të cilat i ka pranuar edhe KQZ-ja mund të eliminohen vetëm nëse ndodh rinumërimi i votave në nivel vendi. Sipas tij, pa rinumërim në tërësi të çdo kutie të votimit, KQZ-ja nuk do të jetë në gjendje të shpallë rezultat zgjedhor në përputhje me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINA, 10 TETOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, e ka kundërshtuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për rinumërim të pjesshëm të kutive të votimit. Ai ka thënë se ky vendim për rinumërim të pjesshëm është i pamjaftueshëm për ta përmirësuar shtrebbërimin e rezultatit.

Në profilin e vet në "Facebook", Limaj ka kërkuar që urgjentisht KQZ-ja ta pranojë gabimin dhe të krijojë kushte për rinumërim të secilës kuti për ta nxjerrë rezultatit zgjedhor. "Duke iu referuar

këtij qëndrimi më lart të KQZ-së, i cili konstaton qartë gabimet në formularin e shpërndarë, vendimi i KQZ-së për të rinumëruar pak më shumë se 300 kuti është skandaloz. Nuk ka nevojë të pritet raporti i QNR-së për ta zbuluar gabimin për të cilin znj. Daka konstatoi se formulari është lëshuar me gabime nga sekretariati i KQZ-së", ka deklaruar Limaj.

Ai ka vlerësuar se me vendim për rinumërim vetëm të 313 kutive, KQZ-ja po krijon standard të dyfishtë. "Ky vendim do të kishte kuptim sikur të kishte dy formula- rë të ndryshëm. Por përderisa dihet se është vetëm një formular i shtypur në një vend dhe i shpërndarë në të gjitha vendvo-

timet e Kosovës, atëherë shtrohet pyetja si është e mundur që një formular nuk mund të procedohet për 300 kuti, derisa qenka e mundur të procedohet për mijëra kuti të tjera. Ky është aplikim i standardëve të dyfishta, që do të thotë për një kuti mund të procedohet, për kuti të tjera s'mund të procedohet", ka vlerësuar Limaj. Më tej, lideri i Nismës ka bërë me dije se KQZ-ja do të bënte shkelje ligjore nëse do t'i pranonte këto ndërhyrje. "Si mund të vlerësohet e pranueshme apo e ligjshme ndërhyrja në formularë nga ana e personave të paautorizuar (komisionarëve në vendvotime) pa autorizimin e organit kompetent. (Fjala është që në shumë formula-

rë komisionarët, duke parë gabimin në formularë, kanë ndërhyrë në bartje të rezultateve të partive politike) dhe nëse KQZ-ja i pranon si të ligjshme këto ndërhyrje atëherë, përveçse pranon falsifikimin, bën shkelje të ligjit dhe rrënon kredibilitetin e të gjithë procesit zgjedhor", ka shkruar Limaj.

Ai ka vlerësuar se KQZ-ja në mënyrë urgjente duhet ta pranojë gabimin dhe ta fillojmë numërimin e votave në nivel vendi. "Ne kërkojmë urgjentisht që KQZ-ja ta pranojë gabimin në tërësi dhe jo pjesërisht dhe të krijojë kushte për rinumërim të secilës kuti për ta nxjerrë rezultatit zgjedhor ashtu siç është brenda kutive dhe t'i eliminojë të gjitha këto gabime skandaloze, shtrebbërimin e rezultatit dhe shumë defekte që janë përcjellë nga ky gabim. KQZ e di mirë se pa e eliminuar këtë gabim, duke rinumëruar në tërësi çdo kuti të votimit, nuk do të jetë në gjendje të shpallë rezultat zgjedhor në përputhje me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe

Rregullores së Punës së KQZ-së", ka shkruar Limaj.

Para dy dite Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) ka hedhur poshtë ankesat nga PDK-ja, LDK-ja dhe koalicioni Nisma-AKR-PD për rinumërim të të gjitha fletëvotimeve nga zgjedhjet e 6 tetorit. Ndërsa të enjten Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur për rinumërimin e 313 vendvotimeve bazuar në rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

Koordinatori i QNR-së, Burim Ahmetaj, në mbledhjen e KQZ-së ka treguar për disa parregullsi që kanë hasur gjatë procesit të numërimit të votave. "Në QNR një numër i rezultateve nuk ka mundur të procedohet siç ishte ndërrimi i shiritave apo edhe mospërputhjet me faqe. Ne i kemi dërguar në karantinë dhe i kemi bashkangjitur raportet. Ky raport thotë se duhet patjetër të numërohet. Në disa vendvotime mungon përputhja me fletëvotime", është shprehur Ahmetaj.

Ndërsa kryetarja e KQZ-së, Valdete

Kurti: Dialogun do ta udhëheq unë, jo presidenti

PRISHTINE, 10 TETOR - Albin Kurti, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se ardhja e tij në postin e kryeministrit do të thotë fillim i qeverisjes së mirë me një njeri i cili e kupton që politika është shërbim, që politika është përfaqësim dhe që politika është vullnet e vizion. Ai thekson se dialogun politik me Serbinë do ta udhëheqë ai dhe se presidenti nuk do të mund ta udhëheqë më këtë proces. "Dialogun do ta udhëheq unë si kryeministër i ri i Republikës së Kosovës, meqenëse shteti ynë i pavarur është republikë parlamentare, është obligim kushtetues dhe

ligjor edhe në bazë të akt-gjykimit të Gjykatës Kushtetuese të këtij viti që unë të jem në krye të ekipit negociator, të ekipit të dialogut për raportet me Serbinë. Presidenti i Republikës së Kosovës është, po ashtu, përfaqësues i politikës së jashtme, mirëpo nuk mund të jetë më krijues i politikës së jashtme siç ka pretenduar në dy vjetët e fundit", ka thënë Kurti. I pyetur se përveç LDK-së, parashihet ta ketë në koalicion ndonjë parti tjetër nga radhët e shumicës si pjesë e koalicionit, Kurti ka thënë se partia e tij dhe LDK-ja i kalojnë 61 deputetë. "Nuk e parashoh një mundësi të tillë, mbase edhe për shkak se

nuk ekziston një nevojë e tillë. LDK-ja dhe LV-ja së bashku i kalojnë 61 deputetë. Ne do t'i fillojmë kontaktet edhe me pakicat joserbe, në mënyrë që edhe 10 ulëset e garantuara nga pakicat joserbe të jenë në qeveri. Megjithatë, sa i përket pakicës serbe, fillimisht do të shohim se çka është e mundur të bëhet me politikanët serbë të cilët e pranojnë pavarësinë e Kosovës, e njohin Republikën e Kosovës, e respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe të cilët, fatkeqësisht, edhe kësaj radhe u ndodhën nën trysinë e Beogradit, në të njëjtën kohë janë viktimat e shkeljeve të panumërta të

procesit zgjedhor më 6 tetor, siç kanë konstatuar tashmë edhe vëzhguesit tanë", ka deklaruar Kurti.

Duke folur rreth postit të kryeministrit nëse do të jetë pjesë e negociatave me LDK-në, Kurti ka thënë se kjo gjë është vendosur më 6 tetor. "Më herët ka qenë i diskutueshëm, më 6 tetor është vendosur një gjë e tillë, e ka përcaktuar populli se kush do të jetë kryeministër i Republikës së Kosovës me diferencën e Lëvizjes Vetëvendosje krahasuar me Lidhjen Demokratike, është përcaktuar nga qytetarët e Republikës sonë se unë jam kryeministri i ri", është shprehur Kurti.

Daka, ka pranuar se formularët janë shtypur gabimisht. "S'po flitet për manipulim, por për një gabim teknik që ka ndodhur për shkak të shtypjes së gabueshme të formularëve. Duhet të deklarohet publikisht e të mos fshihemi. Formularët janë shtypur gabimisht. I kujt është faji do të zbulohet gjatë ditëve të ardhshme. Sekretariati është bartës i shtypjes së formularëve të cilët janë shpërndarë në të gjithë Kosovën. Janë shpërndarë të njëjtët formularë dhe të njëjtët e kanë pasur gabimin teknik. Subjektet ishin të renditura në fletëvotim dhe në formular, por subjektit të parë i mungonte rubrika", ka thënë Daka, duke shtuar se formularët e tillë nuk mund të procedohen me tutje. "Për rrjedhojë të kësaj, disa komisionarëve të cilëve iu ka ndezur llamba i kanë shkruar me saktësi, por disa të tjerëve që s'iu ka ndezur llamba kanë vazhduar nga subjekti i dytë dhe kanë krijuar një hutë. Përfundimisht, QNR-ja i ka zbuluar 303 vendvotime deri më tani, të cilat janë plotësuar në këtë mënyrë. Si përfundim, këta formularë, qoftë sot, qoftë pas një muaji, s'mund të procedohen si të tillë sepse janë plotësuar në mënyrë të gabueshme. Kemi rekomandim për rinumërim të 303 vendvotimeve në tërësi", ka thënë Daka, duke sqaruar gabimet që kanë çuar në rekomandim për rinumërim.

Pas numërimit të plotë të votave të rregullta, koalicioni Nisma-AKR-PD ka arritur të marrë 39 495 vota apo 4.96 për qind, duke mbetur nën pragun prej 5 përqindësh.



'Konferenca Ndërkombëtare për Gjeoshkencë' mbledh studiues nga vende të ndryshme evropiane

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

MITROVICË, 10 TETOR - Të enjten në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) ka filluar punimet "Konferenca Ndërkombëtare e Gjeoshkencës" e cila ka zgjuar interesim të jashtëzakonshëm si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në konferencë janë regjistruar 86 pjesëmarrës, ku janë dorëzuar gjithsej 75 abstrakte, prej të cilave janë pranuar 52 sosh. Përveç studiuesve nga universitetet vendore, në konferencë po marrin pjesë edhe studiues dhe shkencëtarë nga vende të ndryshme të Evropës, si nga Finlanda, Italia, Polonia, Turqia dhe Sllovenia. Konferenca dyditore, e cila organizohet nga UMIB-i, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, është vlerësuar si një ngjarje

jashtëzakonisht me rëndësi për gjeoshkencat.

Rektori i UMIB-it, Alush Musaj, u ka uruar mirëseardhje mysafirëve në këtë konferencë, e cila, sipas tij, paraqet një ngjarje të shënuar jo vetëm për Universitetin e Mitrovicës dhe Mitrovicën, por edhe për gjithë vendin tonë në përgjithësi. "Jemi të nderuar që kemi mundësinë të jemi nikoqirë të një eventi të këtillë, që është futur si ngjarje edhe në listën e aktiviteteve të vitit 2019 nga Shërbimi Gjeologjik Evropian. Do të thotë, konferenca që po e hapim sot është e përmasave evropiane dhe për këtë jemi jashtëzakonisht të lumtur", ka thënë Musaj. Ai ka theksuar se prania e shkencëtarëve dhe studiuesve nga vende të ndryshme evropiane, krahas atyre nga rajoni dhe vendi, i japin kuptim të mirëfilltë kësaj konference për gjeoshkencë. "Kosova dhe Mitrovica, në veçanti për shkak



të specifikave, kanë tepër nevojë për ngjarje të këtij karakteri. Ngjarjet me karakter shkencor kanë qenë të pakta dhe kanë mbetur nën hije të rrethanave politike prej pasluftës e këndeje në qytetin tonë, prandaj kjo kon-

ferencë është një lajm i mirë", ka deklaruar Musaj. Në hapje të konferencës ka folur edhe kryesuesi i Këshillit Organizativ të Konferencës, Sabri Avdullahi, mandej dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave,

Naser Peci, akademik Minir Dushi etj. Pastaj ka vazhduar pjesa plenare ku janë prezantuar kumtesat e studiuesve vendorë dhe të jashtëm. Kjo konferencë do ta vazhdojë punën edhe të premtën.

Mbahet Parada e tretë e Krenarisë në Prishtinë

PRISHTINË, 10 TETOR - Me moton "Për kon t'rreh zema", pjesëtarët e komunitetit LGBTI (homoseksual, lesbike, biseksual dhe transgjinnor), të enjten kanë mbajtur Paradën e Krenarisë në Prishtinë. Kjo është hera e tretë që ky komunitet ka mbajtur një paradë të tillë në kryeqytetin e Kosovës. Gjatë kësaj jave në Prishtinë ka vazhduar "Java e krenarisë" me aktivitete të ndryshme që u kushtohen të drejtave të personave të komunitetit LGBTI.

Gjatë paradës masa u tubua në Sheshin "Skënderbeu" në qendër të Prishtinës duke vazhduar tutje drejt Sheshit "Zahir Pajaziti". Pas marshit nëpër sheshet e Prishtinës, Lend Mustafa, i cili i takon komunitetit LGBTI, ka thënë se kjo është një ditë kur pas shumë kohësh që është dashur të fshihen, po dalin në rrugë me shumë krenari për herën e tretë me radhë.

Duke llogaritur periudhën nga parada e vitit të kaluar deri më sot, ai ka thënë se ky vit i fundit për komunitetin LGBTI nuk ka qenë i lehtë dhe se kanë kaluar në shumë sfida, duke u nisur nga familja deri te rrethi shoqëror. Siç tha ai, shumica e familjeve kosovare nuk i pranojnë fëmijët e tyre kur ata u tregojnë për orientimin e tyre seksual.

Por, qytetarët konsiderojnë se Kosova, sa iu përket të drejtave të komunitetit LGBTI, është shembull për vendet e rajonit. Ardian Nrecaj, qytetar i cili kishte dalë në përkrahje të personave që i takojnë këtij komuniteti, beson se, krahasuar me rajonin, Kosova qëndron më mirë në këtë aspekt. Krahas organizatorëve nga ky komunitet, në paradë morën pjesë edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, si dhe personalitete të



ndryshme nga shoqëria civile. Para dhe gjatë kohës së mbajtjes

së kësaj parade, nëpër sheshet e Prishtinës janë vërejtur forca të

shtuara të Policisë së Kosovës. (REL)

Nënshkruhet marrëveshja për vendosjen e një radari në aeroportin e Gjakovës



PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Rustem Berisha dhe drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Bahri Nuredini, kanë nënshkruar marrëveshjen për vendosjen e radarit në hapësirën e Aeroportit të Gjakovës. Kjo marrëveshje është nënshkruar

bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 14/98, të datës 18 prill 2019, për dhënien në shfrytëzim në kohë të pacaktuar të Aeroportit të Gjakovës për nevojat strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. "Instalimi i këtij radari në Aeroportin e Gjakovës do ta

ngritë edhe më tej sigurinë e fluturimeve civile dhe ushtarake në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës dhe është një hap me rëndësi të veçantë për normalizimin e plotë të hapësirës sonë ajrore, në bashkëpunim me NATO-n", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Laureati i Nobelit për letërsi, përkrahës i Millosheviqit

Nis peticioni kundër nobelistit Handke

Shkrimtari austriak Peter Handke është fitues i çmimit Nobel për letërsi për vitin 2019. Shpallja e këtij çmimi ka nxitur jo pak reagime, pasi Handke u bë i njohur me qëndrimet e veta kundër fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi forcat serbe në vitin 1999 që u dhanë fund mizorive të forcave serbe në Kosovë. Gjithashtu, ai kishte mbajtur fjalim në mars të vitit 2006 në funeralin e ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq. Kundër këtij çmimi për austriakun Peter Handke është iniciuar një peticion online



mërzitur nga vendimi për t'i dhënë Çmimin Nobel për Letërsi një mohuesi të gjenocidit. Çfarë akti i pakuptimtë dhe i turpshëm", ka shkruar Cakaj në llogarinë e vet në "Twitter".

Edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është e zhgënjyer thellësisht me ndarjen e sivjetshme të Çmimit Nobel për Letërsi për shkrimtarin austriak Peter Handke. Për rrjedhojë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës kërkon që të anulohet ky vendim i Akademisë suedeze, si "akt mirëkuptimi e solidariteti me të gjithë popujt e botës që luftojnë për liri dhe vlera demokratike". "Peter Handke nuk ishte në anën e drejtë të historisë së popujve të Ballkanit dhe as të Kosovës. Nuk ishte në anën e ndritshme të ideve, por gjeti strehë në anën e errët të ngjarjeve tragjike të Ballkanit", thuhet, mes të tjerash, në reagimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Kundër këtij çmimi për austriakun Peter Handke është iniciuar një peticion online për ta anuluar dhënien e këtij çmimi. Peticioni në fjalë ka nisur të nënshkruhet të enjten nga shqiptarët.

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 TETOR - Akademia suedeze e Shkencave shpërbleu me Çmimin Nobel për Letërsi autoren polake Olga Tokarczuk dhe autorin austriak Peter Handke. Të parës i takon çmimi i vjetshëm, meqë vjet, për shkak të një skandali seksual që shpërtheu në akademi, nuk u tha, të dytit i sivjetshmi.

Tokarczuk, 57-vjeçare, e konsideruar si romancierja kryesore polake e brezit të saj, u shpërblye "për një imagjinatë narrative, që me pasion enciklopedik paraqet kalimin e kufijve si një formë e jetës", ka njoftuar Akademia suedeze e Shkencave.

Ndërkaq, Handke, 76-vjeçar, u

shpërblye "për punën me ndikim" në "eksplorimin e specifikës së përvojës njerëzore", thuhet në deklaratën e Akademisë. Por, shpallja e laureatit të sivjetmë të Nobelit për letërsi, shkrimtarit austriak Peter Handke, ka nxitur jo pak reagime.

Autori kundërthënës austriak, Peter Handke, që u bë i njohur me qëndrimet e tij kundër fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi forcat serbe në vitin 1999. Ai kishte mbajtur fjalim në mars të vitit 2006 në funeralin e ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq, i cili vdiq në Hagë derisa po gjykohej për krime lufte dhe gjenocid në hapësirat e ish-Jugosllavisë, përfshirë edhe Kosovën.

Ambasadorja e Kosovës në

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), Vlorë Çitaku, ka reaguar pasi austriakut Peter Handke iu dha çmimi Nobel për letërsi. "Nuk ka asgjë fisnike lidhur me këtë. Ky është një vendim i turpshëm", ka shkruar Çitaku në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ish-ministri i Jashtëm në

detyrë i Shqipërisë, Gent Cakaj, ka reaguar pas vendimit për dhënien e çmimit Nobel në letërsi shkrimtarit austriak Peter Handke. "Si një njeri i pasionuar me bukurinë dhe fuqinë e përjetshme të letërsisë për ta pasuruar përvojën njerëzore dhe si viktimë e spastrimit etnik dhe gjenocidit, jam i

Presidenti Thaçi pranoi letrat kredenciale nga ambasadorja e re e Kroacisë



PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadorja e re e Kroacisë, Danijela Barisic.

Presidenti Thaçi fillimit e ka uruar atë për detyrën e re, duke i ofruar bashkëpunim për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy popujve dhe shteteve tona. Ai ka falënderuar Kroacinë për mbështetjen që i ka dhënë Kosovës në të gjitha fushat, sidomos në atë të integritetit euroatlantike. "Kroacia është një partnere e rëndësishme

e Kosovës. Marrëdhëniet tona të mira duhet të zgjerohen edhe në ekonomi, arsim dhe kulturë", ka thënë presidenti.

Nga ana tjetër, ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barisic, ka theksuar se vendi i saj do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën derisa është e përkushtuar për t'i forcuar marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve.

Presidenti Thaçi në fund ka thënë se shtetet e Ballkanit Perëndimorë duhet ta ndjekin rrugën e reformave të Kroacisë për anëtarësim në NATO dhe Bashkim Evropian.

Kuvendi i Prizrenit miraton buxhetin e vitit 2020


Prizren, 10 tetor (ER) - Kuvendi Komunal i Prizrenit ka miratuar buxhetin e vitit 2020 dhe parashikimin buxhetor për vitet 2021 dhe 2022. "Në mbledhjen e VII (shtatë) të Kuvendit Komunal për vitin 2019, të mbajtur sot si

vazhdimësi e mbledhjes së datës 25 shtator 2019, është miratuar buxheti i vitit 2020 dhe parashikimi buxhetor për vitet 2021 dhe 2022. Kjo pikë e rendit të ditës u votua unanimisht nga anëtarët e Kuvendit me 22 vota për. Në

këtë mbledhje u propozua që të hiqen pikat e tjera të rendit të ditës dhe të shqyrtohet për t'u miratuar vetëm pika e V (pestë) për buxhetin e Komunës së Prizrenit", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prizrenit.



Istrefi: Telekom i Kosovës ka zgjeruar gamën e shërbimeve dhe produkteve të reja



PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka thënë se Telekom i Kosovës po i kushton rëndësi të madhe performancës së rrjetit me qëllim që konsumatorëve t'i ofrojë shërbime cilësore dhe pa pagesë. "Telekomi i Kosovës i kushton rëndësi të madhe performancës së rrjetit me qëllim që konsumatorëve t'u ofrojë shërbim cilësor dhe pa pengesa, duke mbetur kësaj udhëheqës i shërbimeve telekomunikuese në vendin tonë. Megjithatë, rrjeti ynë telekomunikues përballet me prishje të përditshme që shkaktohen nga individë dhe kompani të ndryshme private, të cilat merren me ndërtime dhe punë të ndryshme infrastrukturore, duke shkakuar kështu ndërprerje të përkohshme të shërbimit teleko-

munikues", ka shkruar Istrefi në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, Telekom i Kosovës ka zgjeruar gamën e shërbimeve dhe produkteve të reja, të cilat janë shumë atraktive dhe të leverdishme për të qytetarët e vendit tonë. "Duke falënderuar konsumatorët tanë për mirëkuptimin e tyre, ne megjithatë arrijmë që t'i sanojmë defektet e shkaktuara në afatin më optimal, duke rikthyer komunikimin në nivelin e duhur. Për më tepër, ekipet tona gjatë gjithë kohës monitorojnë rrjetin dhe punojnë për riparimin e kablove dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit operativ, sidomos në kohën kur Telekom i Kosovës ka zgjeruar gamën e shërbimeve dhe produkteve të reja, të cilat janë shumë atraktive dhe të leverdishme për qytetarët e vendit tonë", ka shkruar Istrefi.

Shefqet Avdija zgjedhet kryeshef i Postës së Kosovës

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes publike Posta e Kosovës Sh. A. ka zgjedhur unanimisht në pozitën e kryeshefit ekzekutiv Shefqet Avdijen. "Pas një procesi të rregullt, transparent dhe objektiv, në përputhje të plotë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike si dhe me kriteret e konkursit, kandidati më i suksesshëm në garën për pozitën e kryeshefit ekzekutiv është z. Shefqet Avdija, i cili ka marrë pikët maksimale në të gjitha fazat e intervistimit", është thënë në njoftimin e Postës së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, Avdija ka përgatitje të lartë

akademike. "Është doktor shkence në fushën e qeverisjes dhe administrimit publik, ndërkaq në fushën e menaxhimit të sektorit publik ka gradën master. Për rreth shtatë vjet ka qenë në pozitën e zëvendëskryeshefit ekzekutiv në Postën e Kosovës. Në këtë pozitë ai ka shënuar të arritura të mëdha në udhëheqjen dhe menaxhimin e projekteve më sfiduese dhe më të ndjeshme në këtë ndërmarrje publike. Në Postën e Kosovës ai ka mbajtur edhe pozitën e u. d. të kryeshefit ekzekutiv", është theksuar në njoftimin për media të Postës së Kosovës.



Arrestohen pesë persona të dyshuar për falsifikim të dokumenteve



Pas hetimeve disamujore më 9 tetor në lokacione të ndryshme në rajonin e Prizrenit dhe Prishtinës, ka arrestuar pesë persona të dyshuar për veprën penale "falsifikim i dokumenteve".

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Policia e Kosovës me njësitë kompetente për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit, pas hetimeve disamujore më 9 tetor në lokacione të ndryshme në rajonin e Prizrenit dhe Prishtinës, ka arrestuar pesë persona të dyshuar për veprën penale "falsifikim i dokumenteve". "Pesë personat e dyshuar, tani më të arrestuar, duke vepruar në grup në një peri-

udhë kohore, me veprimtari ilegale të shtrirë në disa komuna dhe rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës, në këmbim të pagesave në tarifa të ndryshme, kanë siguruar dokumente zyrtare të falsifikuara, diploma të aftësimi profesional, diploma të shkollimit të mesëm e të tjera, për persona të ndryshëm", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës. Si vazhdimësi e operacionit gjatë

bastisjeve të realizuara në rajonin e Prizrenit dhe Prishtinës janë sekuestruar në cilësi të provave materiale: para, telefona mobilë, kopje të diplomave të profileve të ndryshme, vula, formularë të ndryshëm, forma bllanko të diplomave e të tjera. Të dyshuarit, me vendim të prokurorit kompetent, janë dërguar në mbajtje në kohëzgjatje prej 48 orëve, për procedura të mëtejme ligjore.

2 miliardë e 942 milionë euro vlera e kredive në Kosovë

Vlera e kredive deri më tani në Kosovë është 2 miliardë e 942 milionë euro, ndërkaq 63.6 për qind e këtyre kredive janë kredi biznesore dhe 36 për qind kredi familjare, prej të cilave vetëm 2.2 për qind e portofolit kreditor është kredi joperformuese



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 TETOR - Industria bankare në Kosovë brenda një kohe shumë të shkurtër ka arritur ta përgjysmojë normën e interesit për kredi bankare. Kështu thuhet në komunikatën për medie të dërguar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK). "Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës në dhjetor të vitit 2018, norma mesatare e interesit në kredi të reja ishte 6 për qind apo më e ulëta që ka pasur Kosova ndonjëherë e që paraqet mundësi të mira financuese jo vetëm të klientëve privatë, por edhe të bizneseve të vogla dhe të mesme. Në nivel rajonal, sipas të dhënave krahasuese të publikuara nga Banka Botërore në vitin 2018, rajoni në përgjithësi ka norma të

përafërta të interesit për kredi bankare, ku Mali i Zi qëndron me normën e interesit 6.36 për qind, Maqedonia e Veriut 6.1 për qind dhe Shqipëria 5.93 për qind", është thënë në komunikatën për medie të ShBK-së, duke shtuar se këto zhvillime e vendosin Kosovën në mesataren e rajonit sa i përket normës mesatare të interesit për kredi. "Në anën tjetër, sipas po të njëjtit burim, theksohet se në vitin 2018 Kosova pati rritjen më të madhe të kredive në rajon mbi 11 për qind, ndërkaq Mali i Zi dhe Serbia 9 për qind, e përcjell nga Bosnja dhe Maqedonia Veriore me 5 - 7 për qind. Vlera e kredive deri më sot në Kosovë është 2 miliardë e 942 milionë euro, ndërkaq 63.6 për qind e këtyre kredive janë kredi biznesore dhe 36 për qind kredi familjare, prej të cilave vetëm 2.2

për qind e portofolit kreditor është kredi joperformuese", është thënë në këtë komunikatë.

Në këtë komunikatë është theksuar se përgjatë këtyre viteve sektori bankar në Kosovë është treguar jashtëzakonisht i kujdesshëm duke krijuar portofol kreditor kualitativ, njëkohësisht

duke mundësuar rritje të konkurrencës përmes modernizimit dhe shtimit të numrit të produkteve dhe shërbimeve siç janë e-banking apo kartelat contactless, ndërkaq karakteristike e rëndësishme vazhdon të jetë stabiliteti dhe likuiditeti i lartë, indikator ky që mundëson rritjen e mëtut-

jeshme të kredive të reja. "Përmirësimi i kushteve të të bërit biznes në Kosovë ka mundësuar uljen e normës mesatare të interesit në kredi dhe rritjen e vlerës së përgjithshme të kredive të ofruara dhe kohëzgjatjes së kredive", është thënë në komunikatën e ShBK-së.

ATK-ja mbledh 35.5 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar

PRISHTINË, 10 TETOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka vazhduar ta rrisë nivelin e performancës së të hyrave edhe për periudhën janar-shtator 2019 si rezultat i shtimit të aktiviteve në terren, konkretisht trajtimit të borxheve dhe luftimit të ekonomisë joformale. Për periudhën e lartcekur, ATK-ja ka arritur të mbledhë 35.5 milionë euro të hyra më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa të hyrat e përgjithshme të mbledhura janë në vlerë 372.3 milionë euro. "Përderisa kontributet pensionale i keni në vlerë 132.9 milionë euro, që në total kemi mbledhur 505.2 milionë euro tatime dhe kontribute. Projektioni i ATK-së për këtë vit është 516 milionë euro apo 16 për qind më shumë se plani i vitit të kaluar, mirëpo synimet e ATK-së për këtë vit do të jenë shumë të qarta dhe do të jemi brenda kornizave të Strategjisë së Përbushjes dhe Planit Strategjik. Do të punojmë për luftimin dhe parandalimin e ekonomisë joformale, meqë me

uljen e informalitetit do të kemi rritje të të hyrave dhe, njëkohësisht, krijim të barazisë në treg", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Veç kësaj, ATK-ja ka theksuar se rëndësi të madhe ka rritja e komunikimit me tatimpaguesit, pasi vetëm në këtë mënyrë ata do t'i kuptojnë obligimet të cilat i kanë ndaj administratës tatimore. "Me një qasje të ngjashme si kjo ne do të mund ta kemi këtë paralelizim me konsolidimin e kapaciteteve si dhe kompletimin e infrastrukturës ligjore. Misioni i ATK-së është inkurajimi i tatimpaguesve për përbushje vullnetare, trajtimi transparent dhe gjithëpërfshirës dhe dhënia e këshillave profesionale për implementimin e ligjeve. Ne kemi shkuar në atë drejtim që të krijojmë module që tatimpaguesve t'ua lehtësojmë deklaratimet e tyre. Përmirësimi i shërbimeve për tatimpagues, transparenca dhe ngritja e perceptcionit publik ndaj ATK-së kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë prioritetet tona", është theksuar në njoftimin e ATK-së.



Lehtësia e padurueshme e të bërit presion ndaj një vendi që mbijeton me infuzion!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Pasojat e "bombardimeve" të 6 tetorit: Zgjedhjet përfunduan, pasojat po analizohen. Dikush është euforik, dikush flegmatik, të tjerët janë melankolikë për të kaluarën, ndërsa ka të tillë që tërë këtë proces po e konsiderojnë si ëndërr. Ende nuk po besojnë se është një situatë tjetër. Zgjedhjet i fitoi, me numra LV-ja, e dyta është LDK-ja, e treta PDK-ja, e katërta AAK-ja sepse PSD-ja humbi krejt, kurse Nisma-AKR-PD brenda ditës po vdes dhe po ringjallet çdoherë kur po dalin rezultatet e KQZ-së apo ndonjë mendim i analistëve që, në shumicën e rasteve, më shumë e kanë huqur rezultatit sesa që e kanë qëlluar. Partia e Vuçiqit, Lista Serbe i fitoi të gjitha mandatet, kurse PEK-u, po të mos ia kishin vjedhur ato 83 vota, nuk e di se ku do të përfundonte. Pas zgjedhjeve po bëhen analiza pse nuk fituan dhe pse fituan të tjerët. Në gazetën "Epoka e re" të datës 5 tetor 2019 pata parashikuar se nëse në zgjedhje dalin 42 për qind e më shumë votues, radhitja do të jetë kështu: 1) LV-ja, 2) LDK-ja, 3) PDK-ja dhe 4) AAK-PSD-ja. Gjithashtu, kam thënë se Nisma, pa AKR-në, pa asnjë problem e kalon pragun, kurse me AKR-në, nuk e kalon. Ende nuk është përmbyllur procesi i votimit dhe në këtë situatë që nuk do të prodhojë ndryshime të mëdha. Nisma me Pacollin po bën përpjekje t'i

peshkojë edhe ato 600 vota të nevojshme që të kthehet në Kuvend, kurse LDK-ja shpreson se mund ta kalojë LV-ja e që nuk besoj se mund të ndodhë por, nëse ndodhë, krijohet një realitet tjetër i cili duhet të pranohet. Menjëherë pasi dolën rezultatet preliminare, Kadri Veseli i pranoi ato rezultate duke deklaruar se PDK-ja del në opozitë e që ishte veprim i mençur, por edhe i imponuar politik. Lideri i PDK-së është dashur ta urojë fituesin për ta çuar deri në fund korrektësinë. Nuk ka pushtet të përjetshëm, vetëm veprat janë të përjetshme. Deri më sot, nga këta politikanë që janë gjysmë të gjallë në skenën politike kosovare, asnjëri nuk ka bërë vepra që llogariten të përjetshme siç kanë bërë Bacë Adem Demaçi dhe i pavdekshmi Adem Jashari. Dhe heronjtë që janë sakrifikuar për lirinë time, tuajën dhe të atyre që sot aq pamëshirshëm po e shpërdorojnë duke i bërë njëqindmijë të zeza, në emër të luftës dhe në emër të Ibrahim Rugovës. Tash e kemi një situatë kur LV-ja është fituese e zgjedhjeve dhe kjo duhet të respektohet nga të gjithë. Tash vlejnjë rregullat e Albinit. Janë përcaktuar për koalicion me LDK-në dhe kjo, gjithashtu, është në rregull. Edhe në këtë koalicion rregullat i cakton Albini, jo ai i opozitës, por tash si kryeministër i të gjithëve. Deri tani Albin Kurti ka qenë kryeministër i LV-së, tash është kryeministër i Kosovës. Është e vërtetë se LDK-ja ka pozitë të fortë negociuese sepse, pa LDK-në, aktualisht, as Albin Kurti bëhet kryeministër e as Kosova do të kishte qeveri. Këtë kushtëzim LDK-ja e ka përdorur më herët kur, ndonëse pas vdekjes së Ibrahim Rugovës asnjëherë nuk i ka fituar zgjedhjet, gjithmonë e ka pasur postin e kryeministrit, përjashtuar kohën e Ramush

Haradinajt. LDK-ja gjithmonë ka qenë gomë rezervë për partitë që i kanë fituar zgjedhjet. Nëse LDK-ja ka pozitë të fortë negociuese, LV-ja e ka edhe më të fortë për faktin se, në rastin konkret LV-ja më së shumti do të përfitonte nga zgjedhjet e reja. Por, jam i sigurt se LDK-ja do të paloset pas një kundërshtimi që nuk është fare tundues e lëre më sfidues. Edhe në këtë koalicion LV-LDK, kjo e dyta është përfituese e madhe. Është edhe një situatë e re; nëse më parë faktori ndërkomëtar e ka detyruar LDK-në të bëjë koalicion me krahun e luftës, pas zgjedhjeve të 6 tetorit është presioni që të mos refuzojë koalicionin me LV-në. Albin Kurti nuk lejon që puna si e Behgjet Pacollit me dy deputetë të bëjë koalicion në shtëpinë e tij private dhe ta udhëheqë gjysmën e Qeverisë së Kosovës dhe ta turpërojë Kosovën si ministër për Punë të Jashtme. Albini nuk do ta durojë e as lejojë Hashim Thaçin të lodrojë, si të dojë dhe kur të dojë dhe të luajë koçë... me Kosovën sipas potenciale momentale. Mos mendoni se po i thurë elozhe Albin Kurtit sepse rrugët politike me të i kam ndarë disa vjet më parë, mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk e çmoj dhe respektoj guximin që e ka, intelektualizmin, përgatitjen politike, patriotizmin dhe gatishmërinë për sakrificë. Nëse të tjerët kanë hyrë në politikë apo duan të ndërtojnë karrierë politike nga flladi, Albini e ka bërë këtë me shumë sakrificë, personale dhe familjare, burgje, keqtrajtme, etiketime, përbuzje etj. Historikisht, askush nuk është bërë lider i madh nëse nuk e ka kaluar rrugën e gjatë të shtruar me probleme të mëdha dhe rreziqe dhe Albini është dëshmia më e mirë për këtë! Ndaj Albinit nuk kam asnjë detyrim sikur që nuk as ai ndaj meje përveçse e kam

detyrimin ta përkrah çdoherë kur bënë punë të mira për qytetarin dhe vendin. Unë kam qenë dhe jam përkrahës i autoritetit njerëzor, kombëtar dhe politik të Bacë Adem Demaçit, në kohën kur po jetoj kurse, më parë, si personalitetin kryesor shqiptar kam pasur Hasan Prishtinën.

1. Lëvizja Vetëvendosje: I fitoi zgjedhjet sepse e pati Albin Kurtin në krye. Që nga fillimi ka luftuar ta marrë pushtetin dhe e mori. Pushtetin po e merr në kohën më të keqe të mundshme kur merr shumë përgjegjësi për shkak të premtimeve që i ka bërë dhe pritjeve të mëdha që kanë qytetarët që e kanë votuar. Të gjitha ato që i ka premtuar Albini dhe LV-ja, luftimi i korrupsionit dhe kriminit të organizuar, reformat në polici, gjyqësor, prokurori, arsim, shëndetësi, punësim më të madh etj. kalojnë përmes një ure të ngushtë prej qelqi, bisedimet dhe marrëveshja me Serbinë. Këto bisedime mund ta bëjnë Albini të përjetshëm sikur që mund ta varrosin politikisht, ende pa e përfunduar mandatin. Tjetër gjë është të flasësh dhe të veprosh nga Kodra e Dragodanit e tjetër është të flasësh nga zyrtar komode të qeverisë, të rrethuar me ujër ndërkomëtarë dhe hijena vendore. Kosovës i është bërë dëm i madh edhe deri më tani me këto bisedime, tash i mbetet Albinit të merret me pasojat. Buxheti i Kosovës është buxhet social dhe jo buxhet zhvillimor, prandaj me këtë buxhet është vështirë të bëhen hapa të mëdhenj në kohën kur çdo përkrahje financiare ndërkomëtare kushtëzohet me bisedimet dhe marrëveshjen me Serbinë. E kjo marrëveshje, të gjithë po deklarohen se do të jetë e dhimbshme. Më shumë për Kosovën se për Serbinë. Serbia e ka rikthyer situatën: nga një hum-

bëse e madhe po bëhet një fituese e madhe. Në rrethana normale Serbia nuk ka çka të kërkojë në Kosovë, në rrethanat aktuale ajo është bërë pjesë e vendimmarrjes për zhvillimet në Kosovë! A do të jetë në gjendje Albin Kurti, si drejtues i koalicionit qeverisës, ta sigurojë tërësinë territoriale të Kosovës (në kufijtë e njohjes si shtet), të shtrijë sovranitetin kushtetues në këtë integritet territorial, ta bëjë Asociacionin e Komunave Serbe një OJQ e jo më shumë shtet se vet shteti i Kosovës, së shpejti do ta shohim. Nëse e bën këtë, Albin Kurti do të radhitet në krah të Hasan Prishtinës, nëse në ndërkohë "Hasan Prishtina" i Mitrovicës - Agim Bahtiri nuk do të bëjë një vepër të madhe kombëtare siç ishte largimi nga AKR-ja. LV-ja dhe LDK-ja dallojnë në çdo aspekt, vetëm urrejtja ndaj PDK-së dhe lufta për pushtet i ka bërë bashkë. Tash, të liruar besoj nga kjo urrejtje dhe urrejtja ndaj çdo partie apo individi, kanë kohë të merren me realizimin e premtimeve elektorale. Në euforinë e fitores ka tejkalim të sjelljeve të arsyeshme dhe po bëhen kërcënime të panevojshme. Këto duhet të ndalen nëse nuk duan ta sjellim atmosferën e debatit të Shqipërisë apo ta bëjmë bashkimin kombëtar të kriminit retorik i cili lehtësisht mund të bëhet praktik. Albin Kurti ende është duke përdorur akrobacionet e retorikës opozitare. Me t'u ulur në karrigen e kryeministrit, do të këndohet tjetër këngë. Të gjitha shenjat janë se Albini ka vesh për muzikë dhe po përshatatet në repertorin tjetër të menysë muzikore, jo të opozitës, por asaj qeveritare. Albin Kurti për fillim mund të bëjë kursime duke e deburokruzuar qeverinë dhe duke e bërë një kabinet me pak ministra, pak zëvendëskryeministra dhe duke bërë kursime nga

Komuna e Drenasit shpall konkurs për 160 bursa për studentë

Drenas, 10 tetor (ER) - Komuna e Drenasit ka shpallur konkurs për ndarjen e bursave për studentët e kësaj komune që studiojnë në universitetet publike për vitin akademik 2019-2020. Kjo komunë ka bërë me dije se në këtë konkurs kanë të drejtë konkurrimi vetëm studentët e rregullt të nivelit bachelor në të gjitha fakultet apo drejtimet e

studimit. "Numri i bursave që do të ndahen është 160, ndërsa lartësia e bursës komunale për një student është 500 euro. Këto bursa kanë për synim ngritjen e cilësisë së arsimit dhe janë në vazhdim të përkushtimit të kryetarit, Ramiz Lladrovci dhe Komunës së Drenasit për mbështetjen ndaj studentëve. Secili student që i plotëson

kushtet do ta gëzojë të drejtën e përkrahjes për marrjen e bursës", ka njoftuar Komuna e Drenasit. Konkursi në fjalë do të jetë i hapur deri më 23 tetor, kurse përfituesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale.

Komuna e Drenasit vitin e kaluar ka ndarë 227 bursa për studentë.



keqpërdorimi gallopant i autom- jeteve zyrtare si kapital fillestar. Nëse Albin Kurti dhe LDK-ja, hak- marrjen e shndërrojnë në veprim politik, jetëgjatësia e tyre do të jetë maksimalisht 12 muaj. Edhe bisedimet mund ta shkurtrojnë mandatin e kësaj qeverie. Uroj që të ndodhë e kundërta dhe që Albini, me veprimet që i bënë, do ta fitojë përkrahjen e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Albini dhe LV-ja më shumë do të kenë proble- me me partnerin e koalicionit sesa me oponentët opozitarë, PDK-në dhe AAK-në. Albin Kurti pikërisht në provimin e bised- imeve me Serbinë do të bëhet ose Hasan Prishtina i ditëve tona ose më hashimthaç se vet Hashim Thaçi!

2. Lëvizja Demokratike e Kosovës: Ndonëse humbëse e zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, po del si fituese e ndarjes së pushtetit. Mendoj se mund ta kushtëzonte Albinin duke e frikësuar me zgjedhje të reja por, sikur në të gjitha situatat e ngjashme, u palos dhe institu- cionalisht u rehatua. Është krejtë- sisht e kundërta e LV-së, por sot bota më së miri funksionon si kundërshti midis partnerëve dhe palëve. LDK-ja tash po mundohet të shpëlahet nga e kaluara sepse nuk ka ujë që e lanë për vendimet e dëmshme që i ka marrë më herët, si: decentralizimi në baza etnike, votimi i presidentit Thaçi, demarkacioni me Malin e Zi, voti- mi i Gjykatës Speciale (e ka bërë me pasion), Asociacioni i Komunave të Serbisë në Kosovë dhe të tjera. Me një fjalë, LDK-ja si hisedare e pushteteve të mëparshme e ka ndarë plaçkën me partinë me të cilën ka bashkëqeverisur. Prandaj, mos të moralizojë kur vetë ka qenë pjesë aktive e prostitucionit politik. Tash po hyn në koalicion me LV- në dhe uroj të bëjnë punë të mira. Por, thellësisht jam i bindur se për shumicën e elektoratit të LDK-së dhe politikanëve të saj, udhëheq- jen e qeverisë nga Albin Kurti e marrin si dënim që duhet, për shkak të privilegjëve që i kanë, edhe ta durojnë! LDK-së duhet dikush që i beson t'i thotë se ka kohë që ka vdekur Ibrahim Rugova, se nuk merren votat me vrasjet e aktivistëve të LDK-së pas luftës që nuk janë të zbardhura e që LDK-ja nuk e ka bërë as përp- jekjen më të vogël t'i zbardhë ani

pse ka qenë pjesë e pushtetit dhe ka drejtuar ministrinë që është dashur të bëjnë hetime. LDK-ja duhet të bëjë reforma brenda parti- së duke krijuar një identitet tjetër që do t'i fitojë zgjedhjet vetë e jo të shërbejë vetëm atëherë kur hamshorët kanë nevojë për LDK- në. LDK-ja ka luajtur rol të rëndë- sishëm në të kaluarën dhe këtë mund dhe duhet ta bëjë edhe në të ardhmen. Realisht, LDK-ja nuk ka kondicion ta përcjellë për një kohë të gjatë LV-në dhe nuk do të kalojë shumë kohë kur do t'i nda- jnë rrugët!

3. Partia Demokratike e Kosovës: Mund edhe të çuditeni me vlerësimin tim, por është fituesja më e madhe e këtyre zgjedhjeve. Pse e them këtë?! Nuk ka aferë, sidomos gjatë këtyre katër vjetëve të fundit e të mos jetë përmendur PDK-ja dhe politikanët më të lartë të kësaj partie. PDK-ja përkrahu edhe proceset si Asociacioni i Komunave të Serbisë në Kosovë dhe Demarkacioni e që lëshimin më të madh e ka bërë që e ka përkrahu formimin e Gjykatës Speciale, të cilën, për dallim nga LDK-ja, nuk e ka bërë me pasion, por me presion! PDK-ja ka qenë biseksuale në deklarimin rreth propozimit të Hashim Thaçit për korrigjim të kufijve dhe ndërrim të territoreve. PDK-ja vonë ka filluar reformat brenda partisë të cilat më shumë janë kozmetike se përmbajtësore. PDK-ja deri sot ende nuk ka arritur, as të eliminojë e as t'i menaxhojë elementët destruktivë dhe keqbërës brenda partisë, madje ata vetëm sa kanë fituar pozita dhe forcë. Kadri Veseli ka vullnet ta reformojë partinë duke sjellë rinj, por nuk ka vendosmëri të lirohet nga ujëqerit e vjetër që kanë hëngër dhe po hanë shumëfish më tepër sesa që kanë nevoja reale. Nepotizmi nuk luftohet nëse detyroheni ta zëvendësoni Hasanin me Hysenin e që janë vëllezër. PDK-ja duhet të për- plasat fort për toke dhe që pastaj të bëjë përpjekje të ringritet. PDK- ja do të jetë opozitë konstruktive, por se lista e disave që janë bërë deputetë, me njëqindmijë dalla- vere, nuk më jep shpresë se kjo bëhet shpejt dhe drejt. Asnjëherë nuk mund ta zëvendësoni injo- rantin analfabet politikisht dhe intelektualisht, me një njohës të mirë të politikës dhe intelektual të

dëshmuar. PDK-ja, nëse mbledh mend, mund të rikthehet fuqishëm në skenën politike vetëm pasi të lirohet nga disa banditë dhe keqbërës, injorantë dhe analfabetë, me tituj dhe diploma. PDK-ja, nëse është e vetëdijshme, duhet ta kuptojë se ka kaluar në kohën më të mirë në opozitë kur përgjegjësitë e saj për vendime të mëdha dhe të dhimb- shme kanë karakter fakultativ dhe opozitar. Kur të merren parasysh të gjitha këto, 26 vende në Kuvendin e Kosovës janë sikur dhuratë e Zotit. Para Kadri Veselit është një vendim i madh ose ta reformojë partinë, ose të largohet nga partia. Duhet të jetë 100 për qind vendimmarrës e jo të jetë vetëm aksionar në PDK ku shu- micën dërrmuese të aksioneve i zotëron Hashimi, kurse Kadria e bartë arkën fiskale për ta mbuluar Hashimin! Kadri Veseli duhet ta forcojë anën intelektuale dhe ta minimizojë anën kriminale të partisë. Për këtë arsye e them se PDK-ja është martuar shumë më mirë sesa që e ka merituar!

4. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: Kam pasur më shumë pritje dhe kam besuar se nuk do të bjerë nën 16 për qind të votave. Mendoj se bashkëdyzimi politik me PSD-në e ka dëmtuar shumë AAK-në. Sikur që e ka dëmtuar edhe PSD-në. Po të shkonte PDK- ja në koalicion parazgjedhor me ndonjë subjekt politik, nuk do ta kalonte më shumë se 12-14 për qind të votave. AAK-ja, së bashku me PDK-në, do të jenë opozitë e fortë, besoj shumë konstruktive por, në rast se ua kruajnë shumë bishtin PDK-së dhe AAK-së, do të shndërrohen në opozitë rrënuese. Edhe AAK-ja nuk ka asnjë përgjegjësi për dialogun me Serbinë dhe marrëveshjen even- tuale për faktin se nuk është pjesë e pushtetit.

5. Lista Serbe: Është parti tipike e Ravna Gorës, parti tipike çetnike që nuk e pranon Kosovën, i merr të mirat nga Kosova dhe 100 për qind punon kundër Kosovës si dhe 100 për qind punon për Serbinë. Përveç përkrahjes që e ka pasur nga Serbia, është përkrahu edhe nga partitë kosovare, shqiptare dhe joshqiptare dhe nga bashkësia ndërkombëtare. Ndryshe, nuk do të fitonte aq bindshëm duke terrorizuar serbët

lokalë dhe duke mos u ndëshkuar nga askush. LS-ja nuk do t'i bindet as Albin Kurtit, nuk do ta pranojë si kryeministër prandaj, Albin Kurti duhet të gjejë mënyrë t'i zbusë pakëz ose t'i eliminojë duke mos e duruar çetnikizmin e tyre.

Richard Grenell dhe Metju Palmer: Thuaja para një viti presi- denti Trump i ka dërguar dy urd- hëresa ekzekutive, njëren në Beograd, tjetrën në Prishtinë. Vuçiçi u pati treguar më i përmbajtur, kurse Hashimi pati përjetuar orgazëm. Kjo letër apo Urdhëresë Ekzekutive nuk ishte e mirë për Kosovën, ishte shumë e keqe dhe shumë e dëmshme. Si çdoherë, një pjesë e spektrit poli- tik kosovar këtë letër e mbante nën jastëk për të parë ëndrra të mira. Pas kësaj, dy sharlatanët e Brukselit, Mogi dhe Joni si dhe pobratimat Hasha dhe Aca, me gërshërë në duar i hynë Kosovës (pjesës më vitale të saj) dhe Serbisë (pjesës së okupuar të Kosovës në Serbi e quajtur Luginë e Preshevës) për t'u penguar nga taksa 100 për qind dhe kundërsh- timi 99 për qind brenda Kosovës. Përkohësisht, ai plan u shndërrua në letër për bythët e dorëzuara të Hashimit dhe Edvinit si dhe bythët e forcuara të Aleksandar Fahrudin.

Kohë më parë presidenti Trump, i shndërruar në denoncues të Bajdenit në Ukrainë, Kinë e, mbase, edhe në Rusi, caktoi Metju Palmerin emisar për Ballkan dhe te kosovarët ish in- balljenja të përziera, Hashimi me kotillën e vet politike gëzohej, kurse ata që e duan Kosovën ish in- më të kujdesshëm. Si në përrallën e elefantëve që i dërgoi sulltani në Kosovë, presidenti Trump e emëroi një emisar shtesë, kësaj radhe vetëm për Serbinë dhe Kosovën duke e përmbjllur tresh- en Vuçiç - Thaçi dhe Grenell. Për ta forcuar efektin e frikës, Grenellin e krahasuan me "buldozerin" Holbruk nga i cili politikanët koso- varë mbushnin brekët me ta dëgjuar emrin e tij. Richard Grenell, në takimin me Hashim Thaçin-Shimën, u kap ngrykë si plakat që janë përmalluar dhe nuk janë takuar një kohë të gjatë. Tash nuk po flitet a duhet të bise- dohet, por se duket janë caktuar afatet e arritjes së marrëveshjes. Mendoj se Richard Grenell nuk

ka ardhur ta zgjidhë çështjen e Kosovës, por se ka ardhur të bëjë fushatë elektorale për mandatin e dytë të presidentit Trump. Prandaj edhe është i rrezikshëm sepse Trump do ta zgjedhë këtë çështje shpejt e shpejt dhe pa i interesuar se çfarë pasoja do të ketë Kosova. Takimi midis Thaçit dhe Grenellit tregoi se Shima në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë nuk do t'i bartë çantat e Albinit, por se miqësinë me Acën dhe Edin dëshiron ta kurorëzojë me një nënshkrim në Shtëpinë e Bardhë dhe se do ta ndajnë, të tre bashkërisht, Çmimin Nobel. Realisht, nëse vlera materiale e Çmimit Nobel (një milion euro) ndahet në tri pjesë; Aca, Edi dhe Shima për këta do të jenë para xhepi, para të imëta. Pozita e re nuk duhet ta pranojë asnjë propozim ku përmenden kufijtë, territoret apo kompetencat ekzekutive të Asociacionit. Opozita duhet ta kundërshtojë edhe më fuqishëm. Politikanët kosovarë duhet t'u ofrojnë ser- bëve të Kosovës aq sa iu ofrojnë politikanët amerikanë his- panikëve të integruar në ShBA. Asgjë më shumë. Nëse impono- hen hartat që e gjymtojnë territo- rialisht Kosovën atëherë duhet t'i rikthejmë hartat e Toplicës, Plavës dhe Gucisë si dhe Ulqinit, 60 për qind të territorit shqiptar të Maqedonisë Veriore, disa pjesëve të Greqisë si dhe bregde- tit të Dalmacisë. Nëse përfillen kriteret faktike e që i kanë pran- uar më shumë se 100 shtete, Kosova i ka kufijtë e përcaktuar. Nëse ka vullnet të dhunohen kriteret faktike atëherë duhet të vendosen mbi tavolinë faktet dhe hartat historike. Nuk duhet të negociohet as edhe një milimetër i tokës së Kosovës përkundër që autoritetet politike, morale, kom- bëtare dhe intelektuale si puna e Lutfi Hazirit, Valon Muratit, Hashim Thaçit e sidomos Rexhep Qosjes këmbëngulin për ndërrim territoresh apo tregti me tokat tona! Aspak nuk i besoj Richard Grenellit se ka qëllim të mirë dhe nuk dua të bëhem as në mënyrë indirekte përkrahës dhe votues i Trampit edhe për faktin se mund t'i mbetet hatri Kadrisë! Grenelli po e bën faktike dhe të vërtetë thënien e popullit se: "kush ngutet, përmutet" dhe në rastin konkret të përmutur do të nda- hen vetëm shqiptarët e Kosovës.

Fillojnë punimet për zgjerimin e rrugës Rezallë - Likoc

SKENDERAJ, 10 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për zgjerimin e rrugës Rezallë - Likoc. Me këtë rast, Jashari ka thënë se janë të përkushtuar që të investojnë në çdo pjesë të territorit të

kësaj komune. "Lajm i mirë për banorët e bashkësisë lokale të Rezallës dhe Likocit. Sot filluan punimet për zgjerimin e rrugës Rezallë - Likoc, ku së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, gjeneralin Ilaz Dërguti, Ahmet Zabeli, asamblistin Sami Aruçi dhe

bashkëpunëtorë morëm pjesë në përrurimin e zgjerimit të kësaj rruge. Jemi të përkushtuar që t'i shtrijmë investimet në çdo pjesë, aty ku qytetarët kërkojnë, në mënyrë që të kemi një infrastrukturë më të zhvilluar", ka theksuar Jashari.



Pompeo: ShBA-ja nuk ka miratuar ofensivën e Turqisë në Siri

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka përkrahur vendimin e Trumpit për t'i tërhequr forcat amerikane dhe ka mohuar që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Turqisë "ditën e gjelbër" për ofensivën e saj në Siri

WASHINGTON, 10 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka mohuar që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Turqisë "ditën e gjelbër" për ofensivën e saj në Siri. Pompeo ka mbrojtur vendimin e presidentit amerikan, Donald Trump, që është kritikuar gjithandej për t'i tërhequr trupat amerikane nga pjesa veriore e kufirit, ka njoftuar rfe. Pompeo ka përkrahur vendimin e Trumpit për t'i tërhequr forcat amerikane, duke shtuar se Turqia ka "shqetësime legjitime për sigurinë" dhe "kërcënim terrorist në jug të shtetit".

Ai ka thënë se raportimet që kinse ShBA-ja ka lejuar Turqinë ta nisë ofensivën "janë të pavërteta". "Shtetet e Bashkuara nuk kanë dhënë dritën e gjelbër", ka thënë ai. Edhe presidenti amerikan ka thënë se do ta shkatërrojë ekonominë e Turqisë nëse kalon limitet dhe se ShBA-ja nuk ka përkrahur sulmin turk, duke e konsideruar "ide të keqe".

Trumpi ka thënë, në një konferencë për media, se turqit dhe kurdët "kanë luftuar për shekuj". Republikanët dhe demokratët kanë dënuar vendimin e Trumpit për tërheqje të trupave. Senatori Lindsey Graham, që zakonisht përkrah Trumpin, ka thënë se ShBA-ja ka braktisur në mënyrë të turpshme aleatët e saj. Pas tërheqjes së forcave amerikane, Turqia ka nisur të mërkurën sulmet në territorin e udhëhequr nga forcat kurde, të cilat njihen si aleate të ShBA-së në rajon.

Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë se qëllimi i sulmeve është "parandalimi i krijimit të një korridori të terrorit" në kufi. Sipas tij, Turqia planifikon të krijojë një "zonë të sigurt", duke larguar militantët kurdë, çka do të rezultojë me krijim të strehimit për refugjatët sirianë. "Unë besoj se bashkë me Ushtrinë Kombëtare të Sirisë, Forcat e Armatosura Turke, do të arrijmë sukses të madh kundër Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit, Njësisë për Mbrojtjen e Popullit dhe militantëve të grupit ekstremist Shteti Islamik në Siri. Ne jemi krenarë me ata. Misioni ynë është i qartë. Qëllimi ynë është krijimi i një zone të sigurt", tha presidenti turk. Mirëpo kritikët kanë thënë se operacioni mund të shkaktojë spastrim etnik të popullatës kurde në veri të Sirisë dhe ringjallje të grupit militant, Shteti Islamik (IS).

Forcat kurde në anën tjetër janë zotuar se do t'i rezistojnë ofensivës dhe kanë nisur të përlëshen me trupat turke. Kurdët, që kanë ndihmuar në mposhtjen e militantëve të IS-it në Siri, aktualisht ruajnë mijëra luftëtarë të këtij grupi dhe familjarë të tyre në burgjet dhe kampet që janë në territorin që ata zotërojnë. Ende nuk duhet se si do të ndikojë kjo betejë dhe përshtetëzimi i saj në kujdestarinë e këtyre militantëve.

Çfarë po ndodh në Siri?

Dhjetëra qyteza dhe fshatra janë goditur nga sulmet ajrore të mërkurën, duke shtyrë mijëra civilë që të largohen nga



shtëpitë e tyre. Luftëtarët kurdë kanë thënë se të paktën shtatë civilë janë vrarë, dy prej tyre fëmijë dhe të paktën 19 persona janë plagosur.

Ministria turke e Mbrojtjes ka thënë se trupat turke dhe rebelët sirianë kanë hyrë në zonën "në lindje të Eufratit". Forcat e armatosura turke kanë thënë përmes një postimi në rrjetin social "Twitter" se kanë qëlluar 181 shënjestra "terroriste" në kuadër të të ashtuquajturit Operacioni Pranvera e Paqes derisa një grup pro-turk i ka thënë agjencisë së lajmeve AFP se ofensiva ka nisur në Tal Abyad, zonë e kontrolluar nga militantët kurdë të Njësisë për Mbrojtjen e Popullit (YPG). Autoritetet kurde kanë bërë thirrje për mobilizim të përgjithshëm dhe u kanë bërë thirrje njerëzve që "të nisen drejt kufirit me Turqinë, për të rezistuar në këtë moment të ndjeshëm dhe historik".

Turqia i konsideron militantët

kurdë të grupit YPG, si zgjatim të Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit, e cila ka luftuar për autonominë kurde në Turqi për tri dekada.

Qeveria turke planifikon të dërgojë 2 milionë nga 3.6 milionë refugjatë sirianë sa strehon aktualisht në "zonën e sigurt". Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit ka thënë se ofensiva mund të ndikojë në zhvendosje të 300 000 personave nga shtëpitë e tyre.

Cilat kanë qenë reagimet për këtë ofensivë?

Bashkimi Evropian ka thënë ka pak gjasë që e ashtuquajtura "zonë e sigurt" mund t'i përbushë kriteret ndërkombëtare për kthim të refugjatëve, derisa Belgjika, Franca, Gjermania, Polonia dhe Mbretëria e Bashkuar kanë kërkuar takim në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për të diskutuar këtë çështje.

Të 15 shtetet anëtare të këtij trupi do të takohen të enjten. Liga Arabe, po ashtu, ka njoftuar se do të zhvillojë një takim urgjent më 12 tetor në Kajro lidhur me këtë çështje.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se Turqia, vend anëtar i NATO-s, ka "shqetësime legjitime të sigurisë", mirëpo pret që shteti të përmbahet dhe të sigurojë që secili veprim është i duhur dhe i matur". "NATO-ja është informuar nga autoritetet turke për operacionin në veri të Sirisë. Është e rëndësishme që të anashkalohej veprimet që mund ta destabilizojnë situatën dhe të shkaktojnë më shumë dëme në njerëz", ka thënë Stoltenberg. Përndryshe, në deklaratën e tij Trumpi ka thënë se Turqia duhet të jetë përgjegjëse dhe të sigurojë se luftëtarët e IS-it do të vazhdojnë të jenë në burgje dhe se militantët nuk do të rigrupohen.

Këshilli i Sigurimit do të diskutojë për operacionin e Turqisë në veri të Sirisë



NJU JORK, 10 TETOR - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara pritet të takohet për të diskutuar operacionin ushtarak të Turqisë në verilindje të Sirisë. Ankaraja tha se operacioni i saj antiterror ka qenë i matur dhe i përgjegjshëm. Nga ana tjetër luftëtarët kryesisht kurdë në rajon kanë bërë thirrje për ndihmë, ndërsa luftëtarët kurdë në rajon bëjnë thirrje për ndihmë për t'i shpëtuar njerëzit tanë nga gjenocidi". Në veri të Sirisë ranë në sy përpjekjet e civilëve për t'u larguar nga zona.

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan tha të enjten se 109 "terroristë" ishin vrarë, duke iu referuar luftëtarëve kurdë të Sirisë. Turqia e vazhdoi sulmin edhe gjatë mbrëmjes së ditës së mërkurë, në një përpjekje për t'i larguar forcat kurde të cilat i cilëson si terroriste, në një kohë kur pjesa më e madhe e vendeve perëndimore i sheh ata si partnerë kryesorë në luftën kundër militantëve të Shtetit Islamik. Ministria turke e Mbrojtjes tha se ofensiva po ndërmerret në përpjekje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit dhe dispozitat e ligjit

ndërkombëtar që i japin Turqisë "të drejtën të vetëmbrohet". Në një artikull në "Washington Post", të botuar të mërkurën Hemin Kobane, ndërmjetësi i Forcave Demokratike Siriane me koalicionin e udhëhequr nga ShBA-ja kundër Shtetit Islamik, akuzoi Uashingtonin se ka lënë mënjanë kurdët dhe i "ka lënë fatet e tyre në duart e armiqve". Zyrarët ushtarakë amerikanë konfirmuan se kanë larguar nga zona e rrezikut rreth 50 anëtarë të forcës speciale amerikane, të cilët kishin vepruar përgjatë kufirit Turqi - Siri.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Të flesh mes vreshtave në një fuçi vere

Një kompani që prodhon verë, Quinta da Pacheca, u mundëson vizitorëve që të flenë në fuçitë gjigante që janë vendosur në vreshtat e tyre në Portugali. Vreshtat kanë rreth 10 shtëpiza të tilla në formë fuçie, me nga 30 metra katrorë secila. Brenda dhomave ka shtrat, dush, kondicionuar dhe internet. Çmimi për këtë hotel shkon në 286 dollarë nata.



FOTO E DITES




Vëlla e motër shihen duke luajtur në një vend të mbuluar me bërllok në Kabul, Afganistan. /AP/

E rrallë

Kur gurorja bëhet kompleks turistik

Hoteli Interkontinental Wonderland i Shangait është hapur në Kinë kohët e fundit, por vetëm pak kohë më parë ka qenë gurorë. Hoteli tani ka 336 dhoma dhe ndodhet vetëm 33 kilometra larg qendrës së qytetit. Për ndërtimin e tij u deshën plot dhjetë vjet. Hoteli ka 18 kate, 16 prej të cilave janë nën sipërfaqen e tokës, ndërsa dy janë nën ujë. Vizitorët do të



gjejnë një arkitekturë të veçantë, rrugë prej xhami dhe pamje nga më befaseset nëpër resort.

BARSOLETA E DITËS



Flasin dy gjyshe:

- Sa peshon?, e pyet njëra.
- Me syze, 80 kilogramë.
- E pa syze?
- Nuk e di, se pa syze nuk e shoh peshoren!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Keni punuar shumë


gjatë kësaj periudhe dhe keni dhënë rezultate të cilat nuk mund të kalojnë pa u vënë re.



DEMI

Gjithçka do të shkojë

mirë për ju, dashuria, paratë dhe karriera.



BINJAKËT

Ekziston mundësia të përfshiheni në një

projekt të i, i cili pritet të ndikojë mjaft mirë në gjendjen tuaj financiare.



GAFORRJA

Një ngjarje sociale,

ku mund të përfshihen miq dhe njerëz të biznesit, mund t'ju sjellë ide të reja dhe mund t'ju çojë drejt një rruge të re.



LUANI

Do të ndiheni i fortë dhe

plot energji. Sensi për aventurë do të jetë i lartë.



IRGJËRESHA

Nëse do të përfshiheni

më shumë në jetën e partnerit/partneres suaj do t'ju bëjë të ndiheni më pranë njëri-tjetrit.



PESHORJA

Do të ndiheni të lumtur

teksta jeta juaj personale dhe profesionale po shkon më së miri. Siç duket ju po flirtoni me dikë.



AKREPI

Disa telefonata dhe letra

interesante mund t'ju vijnë sot.



SHIGJETARI

Ka gjasa që ana juaj

financiare t'ju shkojë mjaft mirë, çka do të jetë rezultat i përpjekjeve tuaja të shumta.



BRICJAPI

Ekziston mundësia që të mos

ndiheni energjik si në ditët e tjera.



UJORI

Të lindurit e kësaj

shenje do të mendojnë sot rreth mundësisë së partneritetit në biznes me një prej miqve tuaj.




PESHQIT

Ditë fantastike

për ju sot. Mos e shpenzoni energjinë e sotme.

Drake ndihet i lënduar nga babai i tij



Drake i është përgjigjur babait të tij, Dennis Graham, për pretendimet e këtij të fundit, se reperi gënjeu rreth raporteve të tyre për të shitur rekorde. "U zgjova sot i lënduar. Babai im do t'i thoshte gjithçka gjithkujt që dëshiron ta dëgjojë atë. Është e trishtueshme që familja të jetë kështu, por çfarë mund të bëjmë kur njerëzit që kemi janë

kështu?", ka shkruar Drake në rrjetet sociale. Përgjigjja e reperit u nxit nga intervista e fundit e Graham në Power 106 me Nick Cannon, ku ai i tha radiotelevizionit që djali i tij pranoi të sajonte detaje të marrëdhënies së tyre për të shitur rekorde. Fituesi i Grammyt e ka sulmuar babanë e tij për alkool dhe mungesën e tij në disa raste në të kaluarën.



Scarlett Johansson e lumtur me jetën e saj

Aktorja e njohur Scarlett Johansson ka thënë se është e lumtur me jetën e saj pas fejesës me komedianin Colin Jost. Ajo këtë e tha në një intervistë për "Elle". "Unë jam, sigurisht, shumë

e lumtur dhe e përmbushur në jetën time personale, por jam në gjendje të hyj në pjesë të ndryshme të historisë sime dhe të tregoj si arrita këtu. Është gjithçka e vlefshme", ka thënë Johanssoni.

Angelina Jolie me një fustan ikonik në premierën e "Maleficent"



Angelina Jolie mori pjesë në premierën e Maleficent: Mistress of Evil në Londër sot me një fustan mahnitës me rruaza të bardha

nga Ralph & Russo Couture, duke shfaqur supet e strukturuara. Ajo atje shkoi me fëmijët e saj, Vivienne, Zahara, Shiloh dhe Knox.

12 milionë klikime merr kënga e Ed Sheeran, Cardi B dhe Camila Cabello



Këngëtari i famshëm, Ed Sheeran, ka realizuar bashkëpunimin më të rij, bashkë me reperen Cardi B dhe këngëtares Camila Cabello. Kënga

më e re quhet "South of the border", e cila është publikuar katër ditë më parë dhe brenda kësaj kohe ka marrë rreth 12 milionë klikime në kanalin "Youtube".

KRONISTI I TMERRIT



SALAJDIN SALIHU

Nuk e braktisi Sarajevën e rrethuar, ku ishte afirmuar si poet, si përkthyes dhe si pedagog universiteti. Aty jetoi me dashurinë e tij të përjetshme. Aty, kur filloi lufta, e pa fytyrën prej demoni të disa poetëve. Aty krijoi me dhimbje për viktimat e pafajshme. Aty shkroi me mllef kundër frymëzuesve të kriminelëve. Aty e përfjetoi plagosjen e vajzës shtatëvjeçare. Aty u quajt "poeti i vdekjes, melankolisë dhe trishtimit". Aty u quajt "kronisti i jetës në Sarajevën e rrethuar", në kohën kur "shovinizistët serbë e kishin bërë botën të padurueshme". Është ky Marko Veshoviqi (1945), një ndër zërat më të fuqishëm intelektual kundër spastrimit etnik të popullatës joserbe në Bosnjë dhe më pas në Kosovë, i cili, derisa zgjaste rrethimin i Sarajevës nga forcat ushtarake serbe, jetonte në mesin e njerëzve të trishtuar që e prisnin vdekjen prej granatave të çetnikëve serbë.

"Të gjithë u bëmë vëllezër në pritje të granatave, eksplodimeve, me frikën për fëmijët tanë, qarjet e të cilëve as Zoti në qiell nuk do të mund t'i ndante në serbë, kroatë apo myslimanë".

Nga Sarajeva e rrethuar bënte thirrje për ndërprerjen e çmendarisë shoviniste, por nuk mori përgjigje, sepse "serbët ishin memecë". Memecët e dikurshëm sot flasin për paqen.

Para fillimit të luftës kishte besuar në shpirtin kozmopolit të Sarajevës. "Atëherë flisnim: Çfarë lufte! E si mundet që në Sarajevë të bëhej luftë ndërmyjet rrugicave, rrokaqiejve, sokakëve. Mbase ka pasur profetë që e kanë ditur se çfarë do të ndodhte, por unë nuk kam ditur asgjë".

Në Sarajevë u vranë mbi 11 mijë qytetarë, prej tyre mbi një mijë e gjashtëqind fëmijë. Në këtë periudhë ai shkroi libra me poezi, ese dhe polemika. Vepra më e njohur e kësaj periudhe është "Vdekja është mjeshtre nga Serbia" (1994). Titulli është modifikim i vargut të Paul Celanit: "Vdekja është mjeshtre nga Gjermania".

Në këtë libër ka përfshirë edhe polemikat me përkrahësit e politikës shoviniste serbe. Aty flet për përvojën me Radovan Karaxhiqin, të cilit nuk e kishte

honeshur prej se kishte kuptuar se punonte për policinë sekrete. "Ka një bisedë mes Karaxhiqit dhe njërit prej komandantëve të tij, që thotë: 'Nuk duan serbët të marrin pushkë', kurse ai thotë: 'Vriti he nënën në p...!' Unë këtë asnjëherë nuk mund ta harroj. Si mundetleshkoja, që keqtrajtohej nga gruaja, jo vetëm para meje, por para dhjetëra miqve të tij, e cila e godiste me këpucë, të thoshte: 'Vrite?! Për mua ishte tronditje se sileshkoja u bë kasap'".

Për shkak të qëndrimeve kundër histerisë nacionaliste serbe, Veshoviqi ishte një prej poetëve më të sulmuar prej kolegëve serbë. Kur e quajtnë tradhtar të popullit serb, ai ua ktheu: "Çfarë lyp në mesin e serbëve kur jam gjysmë malazez e gjysmë shqiptar dhe kjo shkruhet shkurt e qartë në origjinën time: se Vaso është themelues i fisit tim, i cili kishte shtatë vëllezër, në mesin e të cilëve Hotin dhe Krasin! Si mund të konsiderohet serb një malazez i afërt me Hotët dhe Krasniqët?!"

Ai ka thënë se mbiemri i tij rrjedh nga fjala shqipe "vesh". Është mburrur me origjinën shqiptare. "Një shqiptar më parë vdes sesa e shkel besën". Megjithatë, Veshoviqi e pranoi se i kishte tradhtuar kriminelët, kurse kjo tradhti për të ishte vlera më e lartë morale kundrejt krimeve të Karaxhiqit, prej të cilëve "të luan mendja dhe gjuha të gurëzohet".

"Me kalimin e kohës tradhtia më bëhet më e dashur, sepse i kam tradhtuar njerëzit që duan të djegin, të themi, xhami, kurse unë jam i bindur se duhet të respektohen vendet e shenjta të të tjerëve. Kam tradhtuar njerëzit që duan, për shembull, të luajnë futboll me kokat e prera të myslimanëve. Për mua koka e njeriut, qoftë myslimane ose jo, është shenjtëria më e madhe në univers, sepse aty është shpirti njerëzor që na lartëson kundrejt kafshërisë. Kam tradhtuar njerëzit që e gjuajnë me snajper fëmijën trevjeçar; kam tradhtuar njerëzit që i vrasin në pritë mjekët e urgjencës; kam tradhtuar njerëzit që me thika vizatojnë kryqe në mishin mysliman. Me një fjalë, kam tradhtuar njerëzit që i kanë tradhtuar të gjitha normat e mundshme mbi të cilat ngrehet kodeksi moral i njerëzimit", tha poeti që kishte refuzuar të bëhej pjesë e presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës, me propozim të boshnjakëve. Ishte justifikuar se shokët e dikurshëm të klasës do të talleshin kur ta mësonin se ai ishte bërë president.

"Unë nuk mund të udhëheq një klasë dhe jo më një shtet", tha

poeti që ishte kritik edhe ndaj elitave kulturore dhe politike malazeze, sepse e kishin përkrahur Serbinë e Millosheviqit, një akt që poeti e quan "turpi malazez". Në një varg thotë se malazezët dinë ta teprojnë për të mirë e për të keq.

"Gjatë luftës 90 për qind të ortodoksëve i përkrahën verbërisht ata që sot duan t'i harrojnë".

Mali i Zi udhëhiqej nga aleati i Millosheviqit, politikani Momir Bulatoviqi.

Veshoviqi, nëpër shkrimet e veta, ku e skenon programin shovinist serb, nuk i ka kursyer as sharjet kundër frymëzuesve dhe ekzekutorëve të luftës. Sipas tij, i verbëri pas një ideologjie beson se njerëzit tjerë janë të devijuar, të pavlefshëm, të padobishëm, tradhtarë. Gebelsi, ministri famëkeq i propagandës naziste, i shkruante Fyhrerit për disa robër anglezë të kapur diku në Saharë: "Tek ata, i dashur Fyhrer, nuk ka asnjë ideologji. Ata janë të privuar prej çdo virtyti njerëzor". Marko Veshoviqi, duke iu referuar kësaj thënie, në kontekst të nacionalizmit serb, shkruan se, sipas kësaj logjike, njeriu pa ideologji është i zhveshur nga ajo që e quajmë njerëzore. "Projekti nacionalist e shuan gjithë njerëzoren tekne".

Në një shkrim ai e përmend rastin e një vajze shqiptare, të rrëmyer diku në Kopaonik. Fqinja serbe i kishte lutur ushtarët serbë që ta lironin shoqen e saj të pafajshme, por ushtari serb e kishte therur shqiptaren. Sipas Veshoviqit, qoftë vetëm për këtë vrasje, do të duhej të pendohej i gjithë populli serb.

Veshoviqi, si pjesëtar i "vertikales morale të Ballkanit", ishte kundër manipulimit me ndjenjat kombëtare dhe shndërrimit të kombit në turmë për të arritur qëllime të caktuara politike.

Poeti vazhdon të mbetet i zhgënjyer për sa kohë skena politike dominohet nga bashkëmendimet e Radovanit të Zi. Ai e kishte njohur mirë edhe Radovan Karaxhiqin, për të cilin thotë: "Ai përherë ka qenë një gënjeshtar, kurse në Hagë gënjen edhe më shumë". Ai më nuk e sulmon Karaxhiqin sepse e ndien veten fitues moral kundrejt tij.

"Unë mund të vdes edhe nesër ose pas 5 apo 10 vjetësh, këtë askush nuk e di, por Karaxhiqi do të vdesë në burg dhe kjo është përparësia ime ndaj tij".

Veshoviqi shpesh ishte tallur me poezitë e Karaxhiqit, veçmas me vargun: "Unë i kam shëruar lesbejtet".

Tani me Karaxhiqin e krahason Milorad Dodikun, prijësin e Republika Serpskës. "Ai është një Radovan Karaxhiq, që vepron me mjete të tjera", thotë ai.

Vitet e fundit ka refuzuar disa çmime letrare për sa kohë laureatë të tyre kanë qenë frymëzues të kriminelëve të luftës ose të gjykuar për krime lufte, sikurse Karaxhiqi.

"Gjatë luftës, në kohën e rrethimit të Sarajevës, kam shkruar librin 'Vdekja është mjeshtre nga Serbia' dhe kam cituar Biblën: 'Fol dhe shpëto shpirtin tënd'. Gjithçka që kam shkruar kundër kriminelëve serbë nuk mendoj se kanë pasur ndikim në rrjedhën e luftës, por e kam shpëtuar shpirtin. Vazhdoj ta bëj të njëjtën gjë. Unë nuk do ta pranoj çmimin me të cilin e kanë stolisur dhunuesin e Durmitorit", tha gjatë refuzimit të një çmimi letrar, që më parë i ishte ndarë Radovan Karaxhiqit. Në kohën kur ndodhte spastrimi etnik në Bosnjë, Karaxhiqi qe nderuar me disa çmime letrare. Një arsye përse nuk duhet të mahnitemi me çmimet letrare. Atij iu nda edhe çmimi "Mihail Sholohov" i Shoqatës së Shkrimtarëve të Rusisë. Shkrimtari kroat, Predrag Matvejeviqi, në atë kohë i bëri thirrje inteligjencës ruse që ta korrigjonte këtë mëkat që përgjithmonë do t'ia rëndonte ndërgjegjen.

Veshoviqi ka polemizuar pothuajse me të gjithë shkrimtarët dhe intelektualët serbë që e përkrahën regjimin e Millosheviqit.

"Neve na godasin shkrimtarët. Na godasin bardët serbë", janë vargjet e një poezie të Veshoviqit.

Në poezinë "Këto krisma" thuhet:

"Krismat na kanë hyrë në gjak. Nuk mund të kthjellohesh pa krisma (si pa kafënë e mëngjesit)".

Në fillim krismat shkaktonin frikë e llahtari dhe shoqëroreshin me heshtjen e njerëzve të frikësuar, kurse pastaj bëheshin gjë e rëndomtë. Madje heshtja krijonte më shumë frikë, sepse nuk dihej se çfarë po përgatisnin çetnikët serbë.

"Heshtja na kall frikën deri në palcë. Dhe sapo kërcet mitralozi qetësohem, gruaja fillon ta përgatitë byrekun, fëmijët rehatohen në shtëpi. Sërish ka krisma, domethënë, sërish gjithçka është në rregull".

Në një shkrim i kundërvihet shkrimtarit Rajko Nogo, një përkrahësi të shovinizmit serb dhe mbrojtës i Radovan

Karaxhiqit. E quan "rrëfimtari i errësirës".

"Bardi nga Kalinoviku me dekada masturbon para popullit të egërsuar, i cili është shndërruar në turmë", thotë për Nogon.

Në një shkrim tjetër polemizon me kolegun e vet të dikurshëm, politikanin serb të Bosnjës, profesorin universitar, përkthyesin, eseistin dhe njërin prej shekspirologëve më të njohur në ish-Jugosllavi, Nikola Koleviqin (1936-1997).

Koleviqi e kishte kërcënuar poetin se do ta ndiqte penalisht për shkak të fytyrës kundër kombit serb. Veshoviqi, duke iu referuar mbiemrit, pra Koleviqi, shkruan se ai tani po thërthe njerëz nga largësia. "Kolja" nga serbishtja përkthehet si "therje".

"Unë tashmë jam i përndjekur. Granatat dhe plumbat e Nikolës ka 22 muaj që më ndjekin nëpër Sarajevë. Tri herë për pak sa nuk më goditën penalisht. Nikola vërtet është shakaxhi i rrezikshëm: më kërcënon me gjyq derisa rreth meje shpërthejnë granatat e tij... Që të më ndjekësh penalisht duhet të bësh edhe diçka të vogël: patjetër ta pushtosh Sarajevën... Fakti se e flas të vërtetën për këtë luftë gjithsesi se më bën kundërshtar të histerisë serbe, sepse të vërtetën në Bosnjë sot e flasin vetëm serbozhderët".

Veshoviqi shkruante se urrejta e Koleviqit ndaj boshnjakëve ishte urrjetje e hyzmeqarit ndaj padronit.

"Me shekuj ke prituri të hakmerresh për përcëmimin që ta kanë bërë si hyzmeqar i turqve. Prandaj e thua se boshnjakët janë 'popull parazit që janë mësuar përherë të jetojnë në llogari të të tjerëve'".

Nikola Koleviqi ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Radovan Karaxhiqit. Më pas u largua nga Karaxhiqi dhe u afrua me Millosheviqin. Koleviqi thoshte se poezia i shpëton serbët, prandaj në kohën e kaosit të luftës organizoi orë poetike me poetët nacionalistë serbë. Në janarin e 1997-s ia shkrep vetes dhe vdiq në Beograd.

Sot Veshoviqi shkruan për gruan e vet Gordanën, dashurinë e tij të përjetshme, e cila ka ikur në amshim. Ajo i qëndroi pranë në kohët më të vështira. Në rini poeti desh ta braktiste, por sakaq hoqi dorë kur dëgjoi rrëfimin e saj.

"Kur për herë të parë i thashë se do të ikja prej saj, për shkakun e një gruaje tjetër me të cilën isha i dashuruar, ajo ma ktheu: 'Kjo është në rregull. Por problemi është se ende të dashuroj', fjalë që më kaluan nëpër zemër. Nuk ishte vetëm kjo që më shtyri të nesërmen t'i thosha tjetrës:

"Nuk mund ta braktis gruan time".

Në një varg kushtuar Gordanës thotë: "A ka arritur deri tek ti lajmi i agjencive se të dua?"

Derisa ajo vuante nga sëmundja, poeti shkruante: "Nuk di si të të ndihmoj, përveç se të të dua".

Marko Veshoviçi jeton në Sarajevë dhe shfaqet rrallë në publik. Ai është sulmuar edhe nga nacionalistët boshnjakë. Kjo fushatë e preku aq shumë sa u zotua se më nuk do të shkruante për Sarajevën. Thotë se në gazeta e lexon vetëm rubrikën e shahut.

"Njerëzit blejnë dhe lexojnë gazeta për ta mësuar se cilin duhet ta urrejnë" dhe "e urrejnë atë që nuk e njohin".

Për të Bosnja nuk është shtet, kurse bijën e tij e lut që të mos kthehet në Sarajevë, sepse qyteti i ëndrrave të tij më nuk ekziston.

Veshoviçi refuzon të takohet edhe me mikun e tij, poetin dhe skenaristin e njohur boshnjak Abdullah Sidran, prej se e pa bashkë me regjisorin Emir Kusturica, "laviren më të madhe intelektuale në Jugosllavinë e shpërbërë". Se Veshoviçi nuk bën kurrfarë kompromisi as me miqtë e tij. "Ose me mua, ose me atë", e porositi Sidranin.

Veshoviçi nuk sheh ndryshime në Serbi, veçanërisht në raport me të kaluarën. E kaluara, sipas tij, është si demoni: nuk mund t'i shmangesh, por duhet të përballësh me të. Serbët nuk duan të përballen me të kaluarën e errët. Ata ende besojnë se bota i urren dhe se e drejta hyjnore është në anën e tyre. Në Serbi u këndohet kriminelëve të luftës. Një këngë serbe thotë: "Të gjithë serbët janë ushtarë të Mladiqit". Apo: "Gjeneral, nëse Zoti na bënë nderë, të na vini sërish në pranverë". Në Serbi adhurohet Millosheviçi dhe kriminelët e luftës, si Karaxhiçi dhe Mladiqi, përgjegjës për vrasjen e mijërave civilëve në Srebrenicë.

Hitleri serb ka shkuar në ferr, kurse himlerat dhe gebelsat serbë shfaqen nëpër ekrane televizive jo vetëm në Serbi, por edhe në Maqedoni.

Veshoviçi, i cili gjithë jetën kishte tentuar ta mësonte se çfarë ishte poezia dhe më pas e kishte kuptuar se ajo vetëm mund të jetohet, sot ndihet fitues moral kundrejt kolegëve të tij serbë, si: Dobrica Qosiqi, Desanka Maksimoviçi, Matija Beqkoviçi, Nogo, Gjoko, Milorad Paviqi apo kundrejt djajve të Kishës Ortodokse Serbe, që fshihen pas petkave të priftërinjve.

Veshoviçi mbeti Njeri. Të jesh Njeri, sipas tij, nuk është punë me leverdi, veçanërisht kur abuzuesit flasin në emër të kombit.

(Marrë nga numri i gjashtë i revistës "Akademia")

ÇIFTI MË I LUMTUR

Përktheu: Jahja HONDUZI

U ul për të dëgjuar radio nga e cila dilte një zë i bukur: "E vendosim mishin në tenxhere, mandej e mbushim me patate... i shtojmë qepë...", e të tjera gjëra që u përmendën atë ditë në programin e amvisërisë.

Duke e dëgjuar këtë, zemra sa s'i fluturonte nga mallëngjimi, prandaj nuk mund të duronte më.

Ia shprehu haptazi familjes dëshirën e tij: "Më duhet të martohem me këtë grua eksperte të ushqimit".

"A e njeh?"

"Jo, nuk e njoh, përveç zërit të saj të ëmbël... ajo po ma dridh zemrën".

Heroi ynë ishte prej të tillëve të cilët nuk bënin dallim mes zemrës dhe lukthit...

Kështu, kur e pyeste mjeku ndonjëherë: "Ku e ke lukthin?" ai bënte me shenjë nga

zemra... e kur e pyeste: "Ku e ke zemrën?" ai bënte me shenjë nga lukthi.

Pra, gruaja që dëshironte t'ia pushtojë zemrën, duhet ta njihje fillimisht rrugën për te lukthi... e kur ta pushtonte atë, atëherë zotëronte gjithçka.

Martesa u bë. Kaluan edhe ditët e para. Burri fluturonte nga gëzimi duke prititur ditën kur gruaja e tij do të hyjë në kuzhinë për t'i përgatitur ato ushqime të shijshme që i përshkruante në radio.

Më në fund erdhi dita e shumëpritur. Gruaja hyri në kuzhinë. Burri u gëzua dhe filloi të lutet për të. Priste me përmallim duke menduar për ushqimin e shijshëm i cili do ta bëjë të lumtur.

Mirëpo, gruaja u vonua gjatë në kuzhinë. Burri priti një orë... mandej edhe një orë... edhe një orë... derisa u lodh nga pritja. Pas pak, gruaja doli nga kuzhina, e mbuluar nga djersët dhe i tha:

"Me keqardhje, të kam përgatitur vezë të fërguara, që të mos të ta vonoj ushqimin".

Nuk mund t'u besonte fjalëve të saj, megjithatë e përmbajti veten. Në asnjë mënyrë nuk i shkonte në mendje se gruaja e tij nuk dinte t'i përgatiste ato ushqime që i prezantonte në radio.

U ul në tryezë dhe filloi të hajë vezë por, ç'të shohë?! Vezët ishin djegur.

Kur u bë ora katër, gruaja shpejtoi për të dalë nga shtëpia sikur kishte një takim të rëndësishëm.

Në orën pesë burri u ul i vetmuar për të dëgjuar radio, kur ja gruaja e tij po u fliste dëgjuesve me zërin e ëmbël:

"E vendosim mishin në tenxhere... etj".

Burri i gjerë mendoi për një çast dhe nuk dinte çfarë të bënte, a të qesh, apo të qajë?

(Marrë nga numri i gjashtë i revistës "Akademia")



TAWFIQ AL-HAKIM

Tawfiq al-Hakim (9 tetor 1898 - 26 korrik 1987) ka qenë një ndër letrarët më prodhimtarë bashkëkohorë egjiptianë. Konsiderohet një ndër pionierët e novelës dhe dramës arabe. Ka shkruar edhe vepra teatrale. Ka lindur në Aleksandri. Babai i tij ishte bujk i pasur, kurse nëna e tij me prejardhje turke nga një familje aristokrate, e bija e një oficeri turk.

Tawfiq al-Hakim shkollën fillore e kreu në Demenhur, të mesmen në shkollën Muhamed Ali në Kairo. Gjatë qëndrimit trevjeçar në Paris studioi teatrin e vjetër grek. Është autor i një numri të madh veprash, në mesin e të cilave: Kthimi i shpirtit, Banorët e shpellës, Harabeli nga lindja, Valltarja e faltores.



Autor: GAZMEND MORINA		AKTORI AMERIKAN STILLER	JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHITJE TË DREJTËSISË	JEVG	IVAN KLASNIÇ	KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA	▼	KRYENGRITËSI QË DILTE MALIT E LUFTONTE MINDERI I ULËT (vjet.)	IVREA	EPOKA E RE	BIMË SHUMËVJEÇARE ME TRUNG TË TRASHË	LLOJ BIME NARKOTIKE
ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT										DY BASHKËTINGËLLORE DRAMË E SANTORIT		
NGJALLJA E KUJTIMEVE PËR DIKË									EPOKË (shq.)			
KANUN, LIGJ (vjet.)					AKTROJA AMERIKANE BASINGER SHTET I MADH NË AZI				SEKRETARI I OKB-së BAN KI QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP (për kafshët)			
EPOKA E RE		BASHKËT. SHPREHET ME FJALË		GJAKATARI BIXHOZ							ZANORE MALI MË I LARTË NË TURQI	
NJERI I VARFËR QË ËSHTË PËR T'U MËSHIRUAR (shq.)								BANORI I ARABISË SAUDITE VARGU I KURANIT				
								BUJKU KËNGËTARJA BERISHA				
KËNGËTARJA SEJDIU ZANORE			NËNA VEPRIMTARI ZEZAK MARTIN KING							ANTIGONA SEJDIU OLIVIER MARTINEZ		
EPOKA E RE	DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR	I SPËRKATA ME UJË	BOKSIERI I NJOHUR KLITSCHKO	"Z" në mes të dy "A"	PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË	TEXAS LIBRARY ASSOCIATION IDRIZ BALAJ		REGJISORI ... QOSJA	TËRËSIA E ORENDIVE SMIRA			
KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)						PËRGËZIMET SHTET (FR.)				MIMOZA AHMETI AKTORJA AJETI		AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS
AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE NË FOTO OLSEN (shqip.)							KËNGËTARI ARIFI ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN				TONI ADAMS QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE	
KËSTET BANKARE PËR KTHIMIN E KREDISË						GRADE USHTARAKE QË KA TË BËJË ME FSHATIN			REGJISORI ... HALILI PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE			
				KOHA E NDARË PËR PUNË POLITIKANI FERID			JETËSHKRIM ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (origj.)				ARMENIA UNITED PROGRESIVE ALLIANCE	
SHIU I IMËT DALLGA					UMA TURMAN AKTORI EGJIPTIAN SHARIF		BISHTUK ME VAJGURI (shq.) QË KA MBUSHUR NJË VIT, MOTAK					PRAPË
ARTANA			ISH MUZIKANTI RUS STRAVINSKI GDHENDUR, LATUAR			PYLLI PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)			I ÇELA ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER			
DY BASHKËTINGËLLORE			FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit greke) PORËSIA E FUNDIT					MA JEP INSTITUCION I LARTË SHKENCOR		AGIM POSHKA KALI I SHALES		
EPOKA E RE	HENDEK PËR TË UJITUR (sh.shq.) LLOJ SHALE DRURI										ZANORE ALBANOLOGIA DURHAM	
FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI (MANCHESTER CITY)						SHEGË LUMË NË SHQIPËRI		BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT SHEJTAN				
ALUMIN, AMPER				KLUBI FUTBOLLI NË GREQI	PAJISJA E VETURËS SË LËSHON TINGUJ REOMIR, INDIUM				OSAKA RROGË VJETORE E PAPËS	IVAN DIXON QË I PËRKET ETIKËS		BALTA E QULLËT, GJANA
KULLË E XHAMISË							SHKRIMTARI ISMAIL STUDENT AID REPORT				IGLESIA GABRIEL NJËSI E VJETËR PESHE	
ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË							ELEMENTI KIMIK (SE)			FUTBOLLISTI FRANCESKO (ROMA) TITAN		
PUNA E PËRDITSHME, ZAKONISHT E MËRZITSHME, PA ASNJË NDRYSHIM											BASHKËT. KRUIJA	
REGJISORJA ELEZI					HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE			LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE				

Qepët me filiza - rastet kur nuk duhet t'i konsumoni

Qepa është perimja që konsumohet më shumë në vendin tonë.

Qepa është pjesë e familjes botanike Allium. Kjo perime ka qenë në krah të njerëzimit prej 5000 vitesh.

Prej shumë vitesh, qepët janë përdorur për vlerat e shumta mjekësore.

Si e tillë, çdo konsumator shqiptar mund të ketë hasur të paktën një herë në jetë fenomenin e qepëve me filiza.

Sa herë që kjo ndodh, mëdyshjet janë të paevitueshme: duhet përdorur qepa që ka lëshuar filiza apo duhet hedhur në plehra ose duhet mbjellë në saksit?

Në këtë artikull, AgroWeb.org do të japë përgjigje për shumë pyetje lidhur me qepët me filiza.

A mund të hahet një qepë e tillë?

Ndoshta. Nëse qepa ka lëshuar rrënjë dhe filiza të vegjël, ndoshta mund të jetë akoma e ngrënshme.

Disa njerëz e pëlqejnë shijen e qepës që shpohet tej për tej nga filizi i gjelbër.

Vegjetarianët adhurojnë qepë të tilla për shkak të nivelit të lartë të proteinës) ndërsa disa të tjerë

shprehen se shija është shumë e hidhur.

Ndodh që filizat nuk janë gjithnjë të gjelbër. Shpesh ato janë të bardhë.

Nëse përballeni me një situatë të tillë, prijëni qepën në gjysmë dhe hiqeni filizin.

Kontrolloni nëse ka zënë myk ose ka filluar të kalbet, sidomos në rastet kur qepa ka qëndruar për më shumë se një javë.

Nëse vini re pak myk, prijëni pjesën e prekur dhe konsumojeni atë të mbetur.

Nëse qepa është e qullët hidheni menjëherë në kosh.

Qepët duhen ruajtur në një temperaturë të freskët, në të kundërt ato do të fillojnë menjëherë të lëshojnë filizat.

Këta të fundit tregojnë se qepa është thjesht e vjetër dhe jo që ajo mund të jetë e kalbur ose e prishur.

Përdorimi i filizave

Filizat e qepëve mund të hiqen dhe të përdoren në sallata dhe në supa. Filizat mund t'i hiqni duke e prerë qepën për së gjati.

Nëse ju pëlqejnë filizat, atëherë qepën vendoseni në një enë me ujë (nga ana e rrënjës) që të



inkurajoni çeljen e më shumë filizave dhe përdorimit të tyre nëpër sallata.

Në rast se qepa nuk ka filiza por është e lagësht në pjesën e rrënjës, atëherë ajo ka nisur të kalbet.

Ruajtja e qepëve

Qepët mund t'i ruani në një

vend të ajrosur mirë dhe larg nxehtësisë dhe dritës.

Kjo perime nuk ka nevojë të ruhet në frigorifer, përveç se në rastet kur keni blerë qepë të njomë.

Mund të zgjidhni një kosh kashte ose një rrjetë, të cilat garantojnë një qarkullim optimal ajri.

Qepët mund të qëndrojnë deri

në një muaj, nëse i mbani në kushtet optimale.

Qepët e njoma kanë një jetëgjatësi më të shkurtër. Nëse i ruani në frigorifer, ato qëndrojnë për një javë.

Mos harroni të mbani qepët larg patateve sepse ato përthithin gazin dhe lagështinë e qepës dhe prishen më shpejt.

/AgroWeb

Shega dhe diabeti - ndikimi në shëndetin e zemrës

Me një pamje po aq mahnitëse dhe interesante sa kanë dhe shijen, shegët mund të quhen eliksiri i vërtetë i jetës.

Kokrrizat e vogla të panumërta me ngjyrën karakteristike të kuqe, mbliidhen në mënyrë perfekte brenda këtij fruti me vlera të jashtëzakonshme shëndetësore.

Shega është pa dyshim një ndër frutat më përfaqësuese të stinës së vjeshtës.

E mbushur me vlera dhe shije, shegët prej kohës njihen si një ilaç natyral që promovon shëndetin e mirë.

Shumë studime dhe ekspertë e konfirmojnë këtë prej vitesh.

Ndaj në këtë artikull nga AgroWeb.org ju tregojmë ndikimin e shegës kundër diabetit dhe për shëndetin e mirë të zemrës.

Si ndikon shega tek diabetikët

Në një studim të publikuar në vitin 2014 të cilit i referohet AgroWeb.org, tregohen vlerat e

shegës tek të sëmurët me diabeti të tipit 2.

Pavarësisht se vetë shega është një frut që përmban sheqer dhe mund të duket si zgjedhje e gabuar, ekspertët thonë të kundërtën.

Në studimin ku morën pjesë vetëm 85 veta të cilët konsumuan sasi të caktuara lëngu shege, u vu re se vetëm pas tre orësh këta persona pësuan ulje të nivelit të sheqerit në gjak.

Megjithëse mjekët nuk japin ende të dhëna se si ky frut e ndikon dhe e heq glukozën e tepërt nga trupi, ka disa shifra se si duhet ta konsumoni.

Këshillohet një sasi e caktuar për konsumin e këtij fruti në ditë në mënyrë që të përfitoni vlera të shumta.

Ekspertët rekomandojnë 1.5 ml për çdo kilogramë, pra rreth 105 ml për një person me peshë 70 kg.

Konsumimi i kokrrave të shegës apo lëngut të saj ndihmon në uljen ndjeshëm të glukozës në gjak.

Duke ulur kështu rrezikun e



prekjes nga diabeti. Këto shifra janë të njëjta si për femra ashtu edhe për meshkujt.

Si ndikon tek shëndeti i zemrës

Lëngu i shegës mund të ndikojë edhe në shëndetin e mirë të zemrës tek të sëmurët me dia-

bet. Ky frut ndihmon në uljen e rrezikut të prekjes nga arterioskleroza.

Gjithashtu dhe një sërë sëmundjesh të tjera kardiovaskulare, të cilat mund të shkaktohen nga diabeti.

Duke qenë një antioksidant shumë i fuqishëm e plot vlera e ndihmon organizmin në

shumë mënyra. Ku përfshihet ulja e sheqerit në gjak, kolesterolit të keq gjithashtu edhe në fëndimin e përhapjes së qelizave të këqija në trup.

Prandaj përfitoni ta konsumoni këtë frut të mrekullueshëm përsa kohë e gjeni të freskët gjatë muajve të vjeshtës. /AgroWeb

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Kosova fiton miqësoren ndaj Gjibraltarit

Futbollistët e Kosovës i janë rikthyer fitoreve, pas humbjes që kishin pësuar nga Angli në kualifikimet për evropianin "Euro 2020". "Dardanët" e mposhtën Gjibraltarin (1-0), kurse përzgjedhësi Bernard Challandes i ka dhënë rastin e shumë futbollistëve që të luajnë në këtë miqësore. Ndeshja e radhës për Kosovën do të jetë të hënën ndaj Malit të Zi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e fituar ndeshjen miqësore ndaj Gjibraltarit (1-0), e cila është zhvilluar të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Rezultati final nuk ishte pasqyrë reale e ndeshjes, pasi "Dardanët" kanë pasur më shumë se dhjetë raste shënimi, por edhe fati shpeshherë nuk ishte në anën e tyre dhe fitorja në fund ishte me vetëm një gol. Në minutën e 11-të, mysafirët provuan me një gjysme-rast, por gjuajtja e Hernandez ishte tepër e plogësht. Dy minuta më vonë, Bernard Berisha bëri një depërtim fantastik dhe asistoi për Muslijën, i cili nuk arriti të shënoi nga afërsia. Berisha që në këtë ndeshje luante si titullar, në minutën e 22-të nga dëshira e madhe për të shënuar nuk arriti të godas si duhet topin me velle dhe rezultati mbeti i pandryshuar. Në minutën e 35-të, Hernandez tentoi për herë të fundit të rrezikojë portën e Ujkanit, por gjuajtja e tij ishte e plogësht. Në këtë pjesë, Kosova pati



edhe dy raste shënimi, por Nuhiu gjuajti lartë me kokë e gjuajtjen e Muslijajt e devijoi një mbrojtës mysafirë. Florent Hasani u inkuadrua në lojë në pjesën e dytë dhe në minutën e 48-të rrezikoi portën e skuadrës kundërshtare. Në minutën e 53-të, Paqarada provon por pa sukses, sikurse edhe Valon Berisha në minutën e 60-të. Nëntë minuta më vonë

vjen goli i parë për vendasit, autor ishte Florent Hasani. Ky futbollist e pati edhe një rast të mirë shënimi pak minuta para fundit, por që nuk arriti ta rikthej në gol. Në këtë ndeshje, trajneri Bernard Challandes i ka jep mundësi që të luajnë shumë futbollistëve që në ndeshjet paraprake nuk kanë pasur mundësinë. Ndërsa fitorja do të jetë një motiv i madh para ndeshjes kualifikuese për kampionatin Evropian "Euro 2020" që Kosova e zhvillon të hënën ndaj Malit të Zi në stadiumin "Fadil Vokrri". Trajneri Bernard Challandes është shfaqur i kënaqur me fitoren e arritur nga Kosova në këtë ndeshje miqësore, por është i pakënaqur me rezultatin e arritur (1-0). "Nuk kam pritur ndeshje më ndryshe se kjo, e kam ditur se kundërshtari është mjaft defensivë. Normalisht se nuk jam i kënaqur me rezultatin 1-0, por në fund kjo është çfarë arritëm. E kemi ditur se do të jetë një ndeshje e veçantë për shkak se ne do të kemi topin, dhe ata do të mbroheshin. Kemi luajtur një ndeshje të mirë në përgjithësi, ishte një ndeshje përgatitore", ka thënë Challandes pas ndeshjes.



SHKURT

Futbollisti malazez paralajmëron Kosovën: Koha ta shijojmë fitoren e parë

Futbollisti malazez, Nikola Vukçević, ka thënë se ka ardhur koha që Mali i Zi ta shijojë fitoren e parë në kualifikimet e "Euro 2020". Malazezët do të luajnë të premtën ndaj Bullgarisë dhe të hënën që vjen kundër Kosovës. "I kemi përpara dy ndeshje mjaft të rëndësishme për ne për shkak të kombëtares, tifozëve dhe Federatës së Futbollit. Për të gjithë ne është nder i madh ta veshim këtë fanellë dhe duhet ta bëjmë më të mirën si në ndeshje me Bullgarinë, po ashtu edhe ndaj Kosovës. Ne nuk do të lejojmë që të jemi të fundit në grup", ka thënë Vukçević.

10 milionë euro e ndajnë Hysajn nga Roma

Elseid Hysaj dëshiron të largohet nga Napoli dhe Roma është e interesuar për transferimin e tij. Tashmë duket se këto fjalë bëhen edhe më të vërteta sepse Davide Zappacosta, mbrojtësi i verdhekuqve, është dëmtuar dhe ka lënë një hapësirë bosh në mbrojtje. Siç raporton "Corriere dello Sport", tashmë Roma ka nisur të punojë për të nënshkruar me shqiptarin, por ka dy pengesa. E para është çmimi i kartonit të Hysajt që është 20 milionë euro. Verdhëkuqtë kërkojnë që ky çmim të përgjysmohet, pasi ai është në përfundim të kontratës.

Rahoveci eliminohet nga FIBA Europe Cup

Nënkampioni i Kosovës në basketboll, Rahoveci, është mposhtur nga Cluji edhe në ndeshjen e kthimit në kualifikimet e FIBA Europe Cup. "Vreshtarët" pësuan në Rumani me rezultat 91:47 (22:18, 29:8, 21:5, 19:16) dhe u eliminuan me rezultat të përgjithshëm 189:120. Rahovecasit i bënë ballë skuadrës rumune vetëm në çerekun e parë dhe atë të fundit. Cluj ishte dukshëm favorit, madje shihet si një nga pretendentët për të fituar në këtë garë. Andrii Kalnichenko u dallua për vendësit me 17 pikë, kurse te Rahoveci u dallua Jure Gunjina me 14 sosh.



Shqipëria sonte zhvillon 'finalen' ndaj Turqisë

Stamboll, 10 tetor - Kombëtarja e Shqipërisë të enjten ka mbërritur në Stamboll ku do të luajë ndaj Turqisë për eliminatorët e "Euro 2020", një sfidë kjo që është përkufizuar nga kuqezinjtë si një finale e vërtetë pasi mund të jetë përcaktuese për ecurinë e skuadrës

kuqezinjtë në këtë fushatë kualifikuese. Objektivi i Shqipërisë për këtë ndeshje pa dyshim është marrja e një rezultati pozitiv për t'i rritur shanset e një kualifikimi të mundshëm. Përballja që zhvillohet sonte do të jetë përballja e 12 në mes të Turqisë dhe Shqipërisë me

skuadrën turke që ka një avantazh të lehtë me 5 fitore, kundrejt 4 të kuqezinjtëve, ndërkohë që 2 ndeshje kanë përfunduar në barazim. Sfidat e fundit mes tyre ishte ajo e 22 marsit, pikërisht për kualifikueset e "Euro 2020" me Turqinë që fitoi me rezultatin 2-0.

FBK-ja nominon gjashtë gjyqtarë për Ligën Ballkanike

PRISHTINË, 10 TETOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), me kërkesë të Ligës Ballkanike, ka nominuar gjashtë gjyqtarë për edicionin e ri 2019-2020.

Nga gjashtë gjyqtarët e nominuar, katër janë me licencë të FIBA-s dhe dy gjyqtarë potencialë për t'u licencuar nga FIBA. Gjyqtarët e nominuar

nga FBK-ja janë: Daut Mehmeti, Dardan Maxhuni, Elion Obërtinca, Xhelal Mumini, Elldin Uglari dhe Ngadhënjim Shabani. Ky është

edicioni i tretë që gjyqtarët e Kosovës gjykojnë në këtë ligë, derisa pjesë e BIBL për edicionin e ri do të jenë edhe Rahoveci dhe Peja.



HIB Petrol, sponsor i ri i Komitetit Olimpik të Kosovës



PRISHTINË, 10 TETOR - Kompania lidere në tregun e derivateve në Kosovë, HIB Petrol, i është bashkuar planit strategjik të marketingut të Komitetit Olimpik të Kosovës. HIB Petrol është sponsor i ri i KOK-ut në rrugën drejt sukseseve të përbashkëta. Kontrata njëvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për kohë më të gjatë u nënshkrua në "Hotel Emerald" nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani dhe pronari i HIB Petroll, Kujtim Bucaliu. Të pranishëm në konferencë ishin edhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj dhe drejtori gjeneral i "HIB Petrol", Hysen Lajçi. Presidenti Hasani ka thënë se është nder dhe kënaqësi që KOK-u si institucioni më i lartë sportiv në vend, nis bashkëpunimin me kompaninë lidere në Kosovë, "HIB Petrol". "KOK-u, ashtu sikurse 'HIB

Petrol', synon majat dhe këto dy vlera na lidhin së bashku. Bashkimi i këtyre dy brendeve do ta krijojë një vlerë të re, e cila do të përkthehet në rezultate më të mira për të dyja kompanitë që përfaqësojmë. HIB-i është i njohur për mbështetje të sportit në Kosovë për dekada të tëra dhe ne shprehim kënaqësinë dhe nderin për këtë bashkëpunim që vjen në kohën kur Ligji për Sponsorizim mundëson një gërshetim të komunitetit të sportit dhe biznesit", ka thënë Hasani.

Edhe drejtori gjeneral i HIB-it, Hysen Lajçi, deklaroi se kanë zgjedhur KOK-un për të sponsorizuar, pasi njëkohësisht do t'i sponsorizojnë të gjithë sportistët e Kosovës. "Kemi lidhur marrëveshje sponsorizimi për t'i përkrahur sportistët e Kosovës, duke i konsideruar se ndajmë vija të përbashkëta me këta

sportistë, të cilët në vitet e fundit e kanë lartësuar lart shtetin e Kosovës, duke sjell medalje të shumta, si dhe duke ngritur flamurin e Kosovës anekënd botës. Tash e tutje sportistët e Kosovës do ta kenë në krahun e tyre kompaninë më të fuqishme të Kosovës dhe besoj se bashkërisht do të krijojmë dhe do të vrapojmë pas sukseseve të reja, pasi vetëm ne si kompani që e dimë vlerën e tregut dhe shijen e fitoreve mund t'i ndihmojmë sportistët kosovarë", është shprehur Lajçi.

Të dyja palët janë zotuar për bashkëpunim afatgjatë dhe krijim të kushteve dhe mundësive të reja për sportistët e Kosovës. Aktualisht, "HIB" është ndër korporatat më të mëdha në vend, e cila ka mbi 1 000 të punësuar të rregullt, në njësinë e "HIB Petrol" dhe hotelit me pesë yje, "Emerald".

Përfundojnë mosmarrëveshjet mes Vettelit dhe Leclercit

ROMË, 10 TETOR - Ditën e diel, në pistën e Suzukas, do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Japonisë në Formula 1, garë ku Ferrari synon të rikthehet protagonist. Charles Leclerc, duke folur për sfidën e radhës, u shpreh se problemet që ka pasur me shokun e vet të skuadrës Sebastian Vettel në dy garat e fundit janë sqaruar. "Kjo është një pistë ku duhet të jemi kompetitivë. Që pas pushimeve kemi një makinë të shpejtë, edhe pse në dy garat e fundit prisja më shumë", ka thënë Leclerc. "Me Vettelin ndodhën disa keqkuptime, por gjithçka u sqarua dhe jam i sigurt se këto gjëra nuk do të përsëriten në të ardhmen. U



takuam dhe biseduam edhe me shefin. Mediet krijuan shumë pluhur për diçka që nuk ekzistonte. Duhet të punojmë për të

mirën e skuadrës, por edhe sfida mes nesh është e rëndësishme, por pa penalizuar askënd", ka deklaruar Leclerc.

SHKURT

Buffoni: U riktheva për ta fituar Ligën e Kampionëve

Gianluigi Buffoni u rikthye në skuadrën e Juventusit vetëm pas një viti të kaluar në PSG. Ai ka bërë me dije se vendosi të rikthehet në Itali për ta mbyllur karrierën, por edhe për ta fituar Ligën e Kampionëve me "Zonjën e Vjetër". "Mundësia për të fituar Ligën e Kampionëve ka ndikuar në këtë zgjedhje. Nuk do të kishte më bukur se ta fitojnë këtë disa djem, me tifozët bardhezinj, apo disa persona që më kanë shoqëruar gjithë karrierën", ka thënë Buffoni.

Varane: E dua në skuadër Mbappen

Raphael Varane ka thënë se gjithmonë dëshiron ta ketë Kylian Mbappen në skuadër, duke rritur në këtë mënyrë thashethemet se sulmuesi mund të kalojë te Real Madridi. Ylli i Paris Saint-Germainit ishte lidhur me një kalim te Reali gjatë kësaj vere që shkoi, ndërsa kishte shprehur dëshirën për një aventurë të re. "Gjithmonë e dua Mbappenin në skuadrën time. Nëse do më pyeste një ditë, do t'i thosha vetëm gjëra të mira për Real Madridin", ka thënë Varane.

Neymar: Doja të largohesha, por tashmë jam i lumtur

Neymari ka folur sërish për dëshirën e tij për t'u larguar nga PSG gjatë verës. Teksa është i grumbulluar me Brazilin ai ka thënë se është i lumtur në kombëtare, por edhe në klub. "Nuk jam i lumtur vetëm në kombëtare, por jam i lumtur edhe te klubi gjithashtu. Të gjithë e dinë se çfarë ndodhi gjatë verës, të gjithë e dinë se unë doja të largohesha, kjo gjë është shpjeguar. Tani jam i qetë dhe i lumtur në klub", u shpreh Neymari. Brazili ka qenë prej kohësh i dëmtuar, teksa që prej rikthimit të tij ka shënuar 4 gola në 5 takime me PSG-në.

Cechi harron futbollin, kalon në hokej mbi akull

Në muajin maj të vitit të kaluar Petr Cech vari dorëzat në gozhdë, pas një karriere të gjatë si portier. Ai luajti për shumë skuadra, përfshirë edhe Chelsea dhe Arsenalin. Ish-portieri çek e ka hapur një kapitull të ri duke luajtur në hokej mbi akull. Për befasinë e të gjithëve ka nënshkruar me skuadrën angleze Guildford Phoenix.

Wilderi e konfirmon rimeçin me Furyn

Deontay Wilder ka këmbëngulur se gatishmëria e tij për t'i pranuar rimeçet me Luis Ortiz dhe me Tyson Fury është një përpjekje e pakrahasueshme për lavdi. Kampioni i botës në kategorinë e rëndë në WBC, Wilder, do të përballet me Ortizin më 23 nëntor dhe tha se edhe rimeçi me Fury do të ndodhë patjetër, transmeton Gazeta Express. I pyetur nga Sky Sports nëse rimeçi i prituri me britanikun do të ndodhë në fillim të vitit të ardhshëm, boksieri amerikan ka thënë: "Po, patjetër. Jam i gatshëm. Edhe një rimeç". "Shikoje rrugën që po e marr. Çfarë duhet tjetër të dëshmoj? Kush e ka marrë rrugën që po e marr unë? Nuk jam i obliguar të ndeshem me të përsëri. Unë jam kampion, çfarë duhet të bëj. Do të ndeshem me Ortizin, pastaj Furyn dhe pastaj për unifikim: një kampion, një forcë, një emër. A e dini sa e mahnitshme do të ishte kjo?", ka shtuar Wilderi.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" SH.A. Prishtinë,
publikon këtë

NJOFTIM

- Anulohen pozitat në Konkursin e shpallur me datën 05.09.2019, në gazetën "Epoka e Re", me të cilin është kërkuar:
Zyrtar ligjor(1), Zyrtar për asete, material dhe inventar në Nj.Punuese "Shkabaj"(1), Zyrtar për asete, material dhe inventar në Nj.Punuese "Vushtrri"(1), Evidentues – Administrator në Nj.Punuese "Komoran" (1), Asistente e Zyrtarit Kryesor Financiar (1), Asistente në Njësinë Punuese "Vushtrri"(1), Asistente në Njësinë Zbatuese të Projektit të Bankës Botërore "Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit"(1), Përkthyes për gjuhët shqipe, angleze, serbe dhe anasjelltas(1), Teknik i ndërtimitarisë (1), Rojtar në Njësinë Punuese "Shkabaj" (1), Punëtor për mirëmbajtjen e kanalit (3), Ndhmës pompist në Stacionin Pompik në Çagllavicë(1)
- I falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit në konkurs.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" SH.A.
Prishtinë, Publikon këtë

NJOFTIM

- Anulohet Konkursi i shpallur me datën 06.09.2019, në gazetën "Epoka e Re", me të cilin është kërkuar: Zyrtar për politika të çmimeve, kontraktime, licenca, shërbime si dhe leje ujore (1).
- I falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit në konkurs



KOMUNA SHITËRPCË
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Nr. pro.: 08-111/01-13745/19
Data:20.09.2019

Bazuar në Ligjin për Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 35; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Ligjin e Punës nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, nr.15/2019, të datës: 19.07.2019, Drejtoria Komunale për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës:

Drejtore në shfmu. "Razim Cokli" në Brod

Koeficient: 7.8

Orët në javë: 40

Kontrata: 4 vjet

Drejtore në shfmu. "Anton Santori" në Bitijë

Koeficient: 7.8

Orët në javë:40 (... plotësohet me 10 orë mësimdhënie)

Kontrata: 4 vjet

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Drejtoria e institucionit edukativo-arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor.
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin e mësimdhënësve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësin dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikqyrjen e punës së aktiveve profesionale dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të Shkollës (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor.
- Raporton dy herë në vit para KDSH
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor. duke përfshir edhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve.
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT);
- Qëshjetet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim;
- Vlerësimi i performancës së drejtorëve do të bëhet me Udhëzimin administrativ (UA) përkatës bazuar në standardet e praktikës profesionale të drejtorëve.

Kushtet:

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e drejtorit, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit:
- Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 330 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar)
- Master arsimor (kualifikim prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar)
- Katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar)
- Bachelor katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar)

Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;

- Të kenë përfundur me sukses një program kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT, sipas rekomandimit të KSHM.
- Të kenë përvojë pune në procesin edukativ-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativ-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë.
- Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativ-arsimor për kandidatët në nivelet tjera dhe
- Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativ-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor.

Të posedoj këto dokumente:

Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;

- Në arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët të mesëm të lartë (gjimnaze), kandidati/ja duhet të jetë i profilin arsimor, në bazë të normativit profesional për arsim të përgjithshëm.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krime, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët.
- Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor.
- Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor për të cilin ka konkurruar. Koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5-10 faqe tekst (një faqe për një fushë) me hapësirë 1.5. fonti i shkronjave 12, arial). Koncepti dorëzohet si pjesë e portfolios, por është edhe pjesë përbërëse kryesore e intervistës;
- Letër reference me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil (si Ministria e Arsimit. Shkencës dhe Teknologjisë, DKA. Këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe të ndryshme për arsim)
- Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon;
- Portfolion profesional.
- Kandidati/ja për drejtor, nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Aplikacionet mirren dhe dorëzohen (të kompletuara) në Komunë, zyra nr. 28

Kërkesa për shprehje të interesitEmri i shkollës: **"Bajram Curri"**Komuna: **Prizren**Data: **11.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/82-CS/1.5	Trajnim: <i>Sistemi i monitorimit dhe evaluimit-sigurimi i cilesise ne shkolla</i>

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren. Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përgjithshme dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përgjithshme të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren, më së largu deri më datën: 18.10.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

Detajet kontaktuese të shkollës:Personi kontaktues: **Refki Demaj**Telefoni: **044/113196**E-maili: **refki-demaj@hotmail.com**




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA E KOSOVO
 KOMUNA E JUNIKUT / MUNICIPALITY OF JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA – REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E JUNIKUT / MUNICIPALITY OF JUNIK – OPŠTINA JUNIK

Kuvendi Komunal
02/01/19
Datë: 11.10.2019
Junik

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komitetit Konsultativ në Komunë, neni 8, paragrafi 1, dhe vendimit të Kuvendit Nr. 002/33 të datës: 04.10.2019, Kuvendi i komunës shpall konkurs publik:

KONKURS PUBLIK
(Për plotësimin me një anëtarë/e)

Institucioni: Kuvendi komunal në Junik
Titulli i vendit të punës: Anëtarë i komitetit konsultativ

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushë veprimtarit e ndryshme në pajtim me statutin e komunës;
- Dhënie e propozimeve për rregullore të ndryshme;
- Hulumtime të ndryshme;
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i komunës, komitetet e përhershme apo kuvendi i komunës në fushën përkatëse;
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të kryetarit i komunës dhe kuvendi i komunës;
- Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuar.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare e dëshirueshme, e obliguar diploma e shkollës së mesme.

Aftësi / përvoja dhetribute tjera që kërkohen: Të ketë aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhimin e punëve, shkathtësi kompjuterike, (Word, Excel).

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë banorët e komunës së Junikut, të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollare dhe aftësi fizike që kërkohet për pozitën përkatëse.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Komunës pranë: **Zyrës së Kryetarit të Komunës.**

Konkursi mbetet i hapur 15 dite nga dita e publikimit nga data: 11.10.2019.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatet e interesuar të komunës së Junikut.

Aplikacionit i bashkëngjitet: Kopja e diplomës mbi kualifikimin, Kopja e Letërnyftimit të Republikës së Kosovës, Ekstraktin e lindjes.

Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushtë për interviste njoftohen: Ueb faqen e komunës, njoftimin në shtetë dhe në afat ligjor për procedurat e intervistimit.




Kuvendi i Komunës së Junikut
Muharrem KRASHOTUNIK



Lagja Ulpiana | Rr. Zija Shemsiu | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
T: 038 700 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

FTESË PËR OFERTIM

IPKO Telecommunications LLC njofton të interesuarit se bën shitjen e kabllove koaksiale dhe fibrave të përdorura.

Dokumentacioni me kushtet e pergjithshme per shitjen e veturave mund të tërhiqet prej dates **08 deri me 11 Tetor 2019** në ndërtesën e IPKO-s në Rr. Zija Shemsiu nr.34, Ulpianë – Prishtinë.

Oferta duhet të dorëzohet në: IPKO Telecommunications LLC, Rr. Zija Shemsiu nr. 34, 10000 Prishtinë, Kosovë, jo më vonë se **18 Tetor 2019 në ora 14:00h.**

Nëse keni ndonjë pyetje sa i përket ftesës për ofertim, ju lutem na shkruani ne adresën elektronike procurement@ipko.com

Me respekt

IPKO Telecommunications
Rr. Zija Shemsiu nr.34 Ulpiane
procurement@ipko.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Jakup Rexhepi, shpall të pavlefshme diplomën e SHF "Azem Bejta" Prekaz i Epërm.

► Nexhmije Aruqi, shpall të pavlefshme Diplomën e SHF."Muharrem Bekteshi " Rezalle

► Edmond Sylaj shpall te pavlefshme deftesat dhe diplomen shmit "11 Marsi" Prizren.

► Alvir Muja shpall te pavlefshme diplomen shmit "11 Marsi" Prizren.

► Armend Ndreca shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shf "Ibrahim Fehmiu " Arbane.

► Ilhan Rama shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf "Mushnikov" Mushnikova.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.